



## **BASHKIA KAVAJË**

*DREJTORIA E PROJEKTIMIT, POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT  
DHE INVESTIMEVE TË HUAJA*

*DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT*



***KAVAJË 2018***

# Përmbajtja

1. SITUATA E PËRGJITHSHME .....	3
1.1 Dinamikat e Urbanizimit dhe Menaxhimit të Territorit.....	3
1.2 Baza Ligjore.....	4
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .....	5
2.1 Objektivat e Projektit.....	5
2.2 Përfitimet e Projektit .....	5
2.3 Metodologjia .....	6
3. STUDIME PËR TERRITORIN .....	6
3.1 Plani i Përgjithshëm Vendor .....	6
3.2 Historiku i Planifikimit Hapsinor .....	8
4. ANALIZA E TERRITORIT .....	9
4.1 Pozicioni Gjeografik dhe Rajonal i Bashkisë Kavajë.....	9
4.2 Problematikat Mjedisore dhe Gjendja Aktuale .....	10
4.3 Analiza e Elementeve të Fortë Territorial SWOT.....	13
5. AKSESUESHMËRIA .....	13
5.1 Lidhja Infrastrukturore dhe Transporti publik.....	14
5.2 Sistemi i Kanaleve Kulluese (dranazhimi).....	15
5.3 Sistemi i Rrjetit Elektrik.....	16
6. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I PARKUT .....	16
6.1 Këndet e lojrave për fëmijë .....	18
6.2 Sheshi qëndror me basenet ujore .....	19
6.3 Lëndina e piknikut.....	21
6.4 Pista e Vrapimit.....	22
6.5 Korsia e biçikletave .....	22
6.6 Kopështi i trëndafilave.....	23
6.7 Terreni sportiv .....	23
6.8 Palestra në natyrë.....	25
6.9 Këndi i shahut .....	26
6.10 Shërbime.....	28
6.11 Kopështi botanik.....	28
7. TIPOLOGJIA E INFRASTRUKTURES RRUGORE .....	29
7.1 Rruga Kryesore .....	29
7.2 Rruga dytësore .....	29
7.3 Rruga tretësore.....	30
7.4 Trajektorja e biçikletave .....	30
7.5 Trajektorja e vrapimit .....	30

8.	GJELBERIMI DHE BIMESIA.....	31
9.	MOBILIMI URBAN .....	35
9.1	Materialët sipërfaqësorë .....	35
9.2	Ndriçimi .....	35
9.3	Stolat e Parkut .....	37
9.4	Kosha për grumbullimin e mbeturinave.....	38
9.5	Vazo lulesh.....	39
9.6	Tenda pushuese.....	39
9.7	Biçiklete-mbajtëse .....	39
9.8	Shatërvanë.....	39
9.9	Sprucator për vaditjen e hapësirave të gjelberta .....	40
10.	RRETHIMI I PARKUT .....	40
11.	IMPLEMENTIMI.....	43



# 1. SITUATA E PËRGJITHSHME

## 1.1 Dinamikat e Urbanizimit dhe Menaxhimit të Territorit

Shqipëria përgjatë periudhave të ndryshme kohore ka kaluar nëpërmjet dinamikave të shumta për sa i përket stileve, formave arkitektonike dhe formësimit territorial të saj. Ndër vite, në vendin tonë janë gërrshetur metodat e ndërtimit vendas me ato Otoman, Romak etj.

Urbanizimi në Shqipëri ka kaluar midis tre fazave të ndryshme që nga rënia e komunizmit. Faza e parë dominohej nga sektori informal. Faza e dytë njohu konsolidimin e sektorit informal dhe kërkesën emergjente për atë formal. Faza e tretë aktuale e gjen Shqiperinë duke ndjekur një model të qëndrueshëm urbanizimi dhe përbëhet nga zhvillimi i mëtejshëm i sektorit formal dhe një rregullim i sektorit informal. Aktualisht, kjo fazë e tretë e stimuluar nga një proces intensiv legalizimi dhe nga sanksione më të forta për shkelësit, ka frenuar ndjeshëm zhvillimet informale duke orientuar zhvillimin drejt planifikimit dhe sektorit formal të zhvillimeve urbane<sup>1</sup>.

Mund të themi se ndryshime rrënjësore vendi ynë pësoi gjatë periudhës Komuniste, nxitur kjo dhe nga zhvillimet teknologjike, industriale dhe sociale te rajonit. Përgjatë viteve 1960 – 1990 në



Shqipëri si pasojë e politikave industriale dhe bujqësore u krijuan shumë vendbanime dhe qyteza të reja si dhe u zhvilluan dhe u zgjeruan ato aktualet. Ndër qytetet të cilat pësuan zgjerime bën pjesë dhe qyteti I Kavajës, ku për herë të parë në zonën urbane të tij u shfaqën fabrikat

industriale dhe zona e shërbimit ushtarak, kryesisht e përlllogaritur

për rezervimin dhe depozitimin e materialeve dhe municioneve të armatimit ushtarak.

(Fig.1)

Shumë pranë qendrës së qytetit, u pozicionua reparti ushtarak bashkë me magazinat për rezervat shtetërore. Ky repart ushtarak kreu funksionin e tij shumë pak vite pas ndryshimit të sistemit nga ai komunist në atë demokrat, që ndodhi përgjatë viteve 1990-1991. Me instalimin e regjimit të ri demokratik, zona e repartit ushtarak, si pasojë dhe e politikave të ministrisë së mbrojtjes, pësoi degradim të ndjeshëm në mirëmbajtjen e objekteve. Në vitet 2010, Ministria e Mbrojtjes me anë VKM nr.1016 datë 10.12.2010 i kaloi Bashkisë Kavajë në përgjegjësinë e administrimit zonën e ish-repartit ushtarak të përbërë nga 71 967.82m<sup>2</sup>.

Ndonëse hapësira e dhënë në menaxhim ishte nën administrimin e bashkisë Kavajë, si pasojë e organeve akoma jo të konsoliduara vendore dhe si pasojë e keqtrajtimit të zonës nga banorët vendas,

<sup>1</sup> Draft-PPV Kavajw, faza I Analiza e Territorit, fq-6.

kjo hapësirë u shndërrua në vendgrumbullim të materialeve inerte. Në këtë zonë, gjithashtu duke shfrytëzuar hapësirat boshe të magazinave të ish-repartit ushtarak, shumë banorë dhe familje me prejardhje Rome I përdorën ato si streh për të akomoduar veten dhe familjet e tyre. Vlen të theksohet këtu fakti se objektet në fjalë nuk përmbushin asnjë kusht minimal jetëse. Situata e higjienës sanitare u përkeqësua ndjeshëm, duke u kthyer kështu në burim potencial për përhapjen e viruseve dhe epidemive të ndryshme me pasojë direkte në shëndetin e banorëve.

## 1.2 Baza Ligjore

Vendi ynë, si pasojë e moskonsolidimit të institucioneve vendimarrëse, ka pësuar ndryshime të shumta legjislative. E gjitha kjo është bërë përgjatë proceseve përmirësuese dhe reformave qeveritare të ndërmara në emër të mirfunksionimit të institucioneve qendrore dhe vendore. Ndër reformat të cilat patën impakt në formësimin dhe administrimin e qeverisjes lokale është reforma administrativo-territoriale. Kjo ndodhi në emer të fuqizimit dhe të konkretizimit të proceseve decentralizuese të pushteteve vendimarrëse. Procesi i decentralizimit ka filluar në vitin 2000 dhe arriti një pikë të fortë me Ligjin Nr. 115/2014 “PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”. Ky ligj i dha fund një herë e mirë ndarjes artificiale në bashki dhe komuna ose zona urbane dhe rurale. Komunitat dhe bashkitë ekzistuese të përthithura nga njësi e re vendore, konsiderohen me ligj si nëndarje të bashkisë të quajtura njësi administrative, të cilat do ruajnë kufijtë ekzistues. Qëllimi është që administrimi i njësive të reja të qeverisjes vendore, sidomos në periudhën e parë të funksionimit me sistemin e ri të ndarjes administrativo-territoriale të garantojnë vazhdimësinë e shërbimeve administrative të drejtëpërdrejta për qytetarët në zyrat ekzistuese të bashkive dhe komunave. Kjo sigurohet edhe duke përcaktuar në ligjin organik të qeverisjes vendore, detyrimin për të pasur në këto njësi administrative (ish-njësi të qeverisjes vendore) një administrator lokal/administratë lokale.

Gjithashtu Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, është miratuar në datën 31.07.2014 dhe ka hyrë në fuqi në datën 01.10.2014. Me hyrjen në fuqi të tij është shfuqizuar Ligji Nr.10119 datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”. Ky Ligj ka për qëllim ndër të tjera të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit; të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor; të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore; të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës; të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë; të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit; të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit.

Në zbatim të ligjit 107 datë 31.07.2014 I ndryshuar, kanë dalë dy VKM, përkatësisht VKM nr.686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së Planifikimit të territorit” e cila shfuqizoi VKM-në nr. 671 datë 29.07.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, si dhe VKM nr.408 datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” I ndryshuar. Këto dy VKM (686 & 408) janë bazat legjislative të cilat mundësojnë zbatueshmërinë e ligjit nr.107.

Në lidhje me legjislacionin për menaxhimin e hapësirave të përbashkëta komunitare, Këshilli I Ministrave ka miratuar VKM Nr. 1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e

procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirave publike`. Ky vendim vjen në zbatim të ligjit 107/2017 `Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit`, i ndryshuar.

Në këtë VKM përcaktohen rregullat, kushtet e procedurat për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike si dhe ky vendim rregullon hapësirat publike ekzistuese si dhe ato që krijohen në zbatim të dokumenteve të planifikimit. Vendimi në vetvete përmban trajtimin juridik, si të rasteve kur bashkia nuk e ka ende të miratuar Planin e Përgjithshëm vendor, ashtu edhe kur ky plan është i miratuar dhe shumë zona të përbashkëta komunitare mund të kenë nevojë për ndërhyrje, bazuar në përcaktime dhe kritere të ardhura nga Plani I Detajuar Vendor.

## **2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

### **2.1 Objektivat e Projektit**

Duke iu referuar objektivate të përgjithshme të nxjerra nga ligji i Planifikimit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, si dhe VKM-ve në zbatim të tij sic janë VKM nr. 408 datë 13.05.2015 `Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit` I ndryshuar, VKM 686 datë 22.11.2017 `Për miratimin e rregullores së Planifikimit të territorit` si dhe VKM nr. 1096 datë 28.12.2015 `Për Miratimin e Rregullave Kushteve e Procedurave për Përdorimin dhe Menaxhimin e Hapësirave Publike, Projekti i Krijimit të Parkut Qendror Rekreativ në zonën e ish-repartit ushtarak synon në vetvete të arrijë dhe të përmirësojë objektivat e poshtëshënuara, të cilat në fokus të tyre kanë përmirësimin e jetës dhe kushteve sociale të komunitetit Kavajas dhe më gjërë.

- I) Krijimi dhe shtimi i hapësirave të gjelbërta në shërbim të komunitetit
- II) Krijimi i mundësive socializuese për grupmoshat e ndryshme të qytetarëve
- III) Reduktimi i treguesve ndotës të ajrit (dioksidit karboni) duke shtuar mbjelljen e pemëve
- IV) Rigjenerimi i zonave të abandonuara dhe shndërrimi i tyre në ambjente plotësisht të sigurta dhe të aksesueshme për banorët
- V) Krijimi i ambjenteve të reja relaksuese dhe sportive (pistë biçikletash, fusha basketbolli, kënde lojrash etj.)

Bashkia Kavajë, si konceptuese dhe hartuese e projektit rekreativ qendror të parkut në zonën e ish-repartit ushtarak, synon konkretizimin e objektivate të lartëpërmendura me anë të zbatimit të projektit në faza të përcaktuara. Të gjitha objektivat e cituara më sipër, në fokus të tyre, mbartin vetëm interesin e përbashkët komunitar.

### **2.2 Përfitimet e Projektit**

Parku Qendror Rekreativ, i përcaktuar si zemra e gjelbërt e qytetit, do të shërbejë si pikë frymëmarrje e banorëve, të cilët aktualisht vuajnë nga mbingopja e urbanizimit të hapësirave të përbashkëta komunitare nga materialet e ngurta siç janë betoni, asfalti etj.

Më saktësisht, qyteti i Kavajës ndonëse si bashki më e madhe në aspektin territorial dhe numër banorësh e përcaktuar nga ligji Ligji nr. 115/2014 “PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E

SHQIPËRISË”, përsëri vuan ndjeshëm mungesën e hapësirave të përbashkëta të organizuara dhe menaxhuara nga qeverisja vendore.

Bashkia Kavajë përbëhet nga 5 njësi administrative që janë:

- Njësia administrative Golem
- Njësia administrative Synej
- Njësia administrative Helmas
- Njësia administrative Kavajë
- Njësia administrative Luzi Vogël

Në secilën nga këto njësi administrative, edhe pse tipologjia e tyre është kryesisht rurale, hapësirat e përbashkëta komunitare janë shumë të pakta. Konkretizimi i parkut qëndror do të shërbejë si një pikë atraksioni jo vetëm për banorët e qytetit, por edhe për rezidentët e njësive administrative përkatëse. Ritheksojmë këtu se, edhe pozicioni gjeografik i parkut dhe aksesueshmëria e lehtë e tij nga mjetet e transportit publik, lehtëson akoma më shumë përdorueshmërinë e tij nga banorët.

### **2.3 Metodologjia**

Proçesi i hartimit të projektit të Parkut Rekreativ qëndror të Bashkisë Kavajë ka kaluar në disa hapa, të cilat lidhen me mbledhjen e të dhënave cilësore dhe numerike. Bashkia Kavajë, në koordinim të brendshëm me drejtoritë e saj përkatëse, ka kryer proçedurat për përcaktimin e kufinjëve të zonës së projektit. Më pas, specialistët përkatës të përbërë nga juristë, arkitektë, urbanistë dhe inxhinierë, kanë vizuar me vizitat në terren dhe hedhjen e skicimeve paraprake të koncept ideve rreth organizimit të hapësirës në fjalë.

Konkretisht, metodologjia e hartimit të projektit të parkut qëndror rekreativ të bashkisë Kavajë përfshin hapat e mëposhtëm:

- Vizitat në terren
- Konsultime me specialistët e fushës
- Korrespondencat me drejtoritë dhe organet përkatëse
- Përshtatja me projektin me strategjinë e Planit të Përgjithshëm Vendor
- Përgatitja teknike e projektit
- etj.

Hapat e lartpërmendur kanë shërbyer si pika reference, ku i gjithë projekti dhe proçedura e projektimit të tij është bazuar.

## **3. STUDIME PËR TERRITORIN**

### **3.1 Plani i Përgjithshëm Vendor**

Bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 36 datë 21.11.2015 “Për Miratimin e Nismës së Planit të Përgjithshëm Vendor”, Bashkia Kavajë me mbështetjen financiare nga qeverisja qëndrore ndodhet në prag finalizimi të miratimit të PPV-së në Këshillin Kombëtar të Territorit. Ky plan përbën dokumentin më të rëndësishëm strategjik të bashkisë. PPV ushtron vlefshmërinë e saj për një periudhë kohore 15-vjeçare. Referuar Ligjit 107/2017 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e

Territorit` i ndryshuar, si dhe VKM 686 datë datë 22/11/2017 ``Për miratimin e rregullores së planifikimit të territory`` theksohet se:

### Neni 26

#### Rishikimi i planeve

1. Planet e përgjithshme janë objekt ndryshimi, kur është e nevojshme, sipas pikës 2, të këtij neni, dhe në çdo rast objekt rishqyrtimi të plotë çdo 15 vjet. Procesi për 21 shqyrtimin e plotë të tyre fillon 2 vjet para përfundimit të afatit të sipërpërmendur, sipas së njëjtës procedurë të ndjekur për miratimin e tyre. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit do të jetë subjekt vlerësimi, në përshtatje me faktorët e rinj, socialë, ekonomikë dhe mjedisorë, të paktën në fund të çdo 5-vjeçari, në përputhje me kornizën kohore të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

2. Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Dokumenti i PPV-së në vetvete është konceptuar si një paketë e plotë e përbërë nga dokumentat e mëposhtëm dhe si dokument që miratohet më një ndalesë:

- i. Dokumenti i Analizës së Territorit
- ii. Dokumenti i Strategjisë së Territorit
- iii. Dokumenti i Planifikimit të Territorit
- iv. Dokumenti i Rregullores së Zhvillimit
- v. Dokumenti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
- vi. Dokumenti hartografik (dixhitalizuar)

Cdo fazë e PPV-së përmban konsultimet, dëgjuesat dhe forumet me organet përkatëse të përfshira në procesin e hartimit, bashkitë kufitare, grupet e interesit dhe qytetarët e bashkisë Kavajë. Dokumenti i strategjisë së zhvillimit të PPV Kavajë përmban 4 objektiva kryesore:

- O\_1 Fuqizimi i sektorit primar të ekonomisë (bujqësi, blegtori) dhe mbështetje e fermerëve*
- O\_2 Zhvillimi i ekonomisë rajonale*
- O\_3 Zhvillimi i vendbanimeve në gjithë territorin dhe përmirësimi i cilësisë së jetës në to*
- O\_4 Ruajtja dhe promovimi i resurseve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore*

Gjithashtu, PPV-ja bazohet dhe zbërthen më tej Strategjinë Territoriale.

- Përkthen vizionin dhe strategjitë në tiparet thelbësore të modelit hapësinor të zhvillimit, për një periudhë afatmesme zhvillimi, me një projeksion të pritshëm deri në vitin 2031;
- Zbërthen dhe detajon më tej rekomandimet e planeve Kombëtare, rajonale etj;
- Evidenton rishpërndarjen e sistemeve territoriale sipas rekomandimeve strategjike; etj.
- Parashikon masat mbrojtëse dhe u jep përgjigje kufizimeve kryesore dhe problematikave të identifikuar gjatë analizës;
- Përcakton zonat dhe ndërhyrjet bazë për përmirësimin e mjedisit dhe peizazhit natyror dhe atij urban;



- Përcakton vendndodhjen e rrjeteve kryesore dhe ambienteve të shërbimeve publike, si për ato ekzistuese, ashtu edhe për ato në perspektivë zhvillimi;

Bazuar në strukturën e përgjithshme të zhvillimit të përcaktuar në “Propozimet Territoriale”, në zonimin e planit është bërë edhe kategorizimi i përgjithshëm i përdorimit të tokës dhe shpërndarja, si dhe parashikimet për dendësitë e pritshme të vendbanimeve në të gjithë territorin; Zonimi përqëndrohet në “qëllimet e planit”, pra në ato lloj ndërhyrjesh që janë të nevojshme për të përmbushur objektiva e zhvillimit- kushte të përmirësuara, strukturë dhe rrjete funksionale- në secilën prej zonave urbane.

Për secilën zonë të planit (grup njësisish) janë përcaktuar llojet dhe kushtet e zhvillimit, parametrat dhe kërkesat për secilën kategori dhe nën-kategori të përdorimit të tokës. Janë përcaktuar zonat ku duhet të hartohet Plani i Detajuar Vendor (PDV) dhe përgjegjësitë për zhvillimin e zonave të caktuara të Bashkisë. Këto rregulla janë të paraqitura në Rregulloren Vendore, pjesë e dokumentave të Planit të Përgjithshëm Vendor. Zbatimi i planit lidhet ngushtë me rritjen e kapaciteteve të bashkisë, me financat e saj dhe me disponibilitetin e donacioneve dhe investimeve nga pushteti qëndror.

### 3.2 Historiku i Planifikimit Hapsinor

Në imazhin e mëposhtëm, shkëputur nga Arkivat Qendrore Teknike të Ndërtimit (AQTN), vërehet se struktura urbane e qytetit të Kavajës ka qenë trajtuar edhe më parë. Një rëndësi e veçantë i është dhënë rrjetit rrugor. Është krijuar një strukturë e rregullt urbane, duke sugjeruar hapjen e rrugëve të reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese, të cilat në pjesën dërrmuese të rasteve nuk e kanë konsideruar ose kanë anashkaluar problematikën e pronës private dhe zbatimi i tyre do të sillte shpronësime dhe prishje të konsiderueshme.

Në planin e vitit 1983, (Fig.2) shikohet qartazi se si prania e hapësirave të gjelbërta është trajtuar me kujdes dhe profesionalizëm. Krijimi i brezave të gjelbër, parqeve publike dhe elementëve sociale, kulturore dhe arsimore pranë tyre, në qoftë se do të ishin ndërtuar në bazë të planeve, do të kishin ndryshuar në mënyrë të dukshme imazhin e Kavajës në ditët e sotme, duke e shndërruar në një qytet të gjelbër dhe me hapësira të bollshme publike, si dhe duke lehtësuar politikat aktuale të rimëkëmbjes urbane.





Fig. 2 Planimetri e qytetit e vitit 1983

## 4. ANALIZA E TERRITORIT

### 4.1 Pozicioni Gjeografik dhe Rajonal i Bashkisë Kavajë



Bashkia Kavajë bën pjesë në ultësirën perëndimore të vendit tonë.(Fig.3). Kavaja përfshihet në qarkun e Tiranës dhe posedon një sipërfaqë prej 98,81km<sup>2</sup>. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kavajës. Bashkia e re përbëhet nga pesë njësi administrative të cilat janë: Kavaja, Synej, Luz i Vogël, Golem dhe Helmas. Të gjitha janë pjesë e Rrethit Kavajë të Qarkut Tiranë. Bashkia e re ka një qytet dhe 32 fshatra. Sipërfaqja e përgjithshme e Bashkisë Kavajë është 198,81KM<sup>2</sup>. Bashkia e Kavajës shtrihet në një zonë kodrash të buta dhe fushash pjellore përreth qytetit të Kavajës, deri në detin Adriatik, ku gjenden plazhe pjesërisht ranore dhe pjesërisht shkëmbore. Bashkia Kavajë kufizohet me bashkinë Durrës në veri, me bashkinë Tiranë në lindje, me bashkinë Rrogozhinë në jug dhe me detin Adriatik në perëndim.

Fig. 3 (Imazh i shkëputur nga Analiza e Territorit / PPV-Kavajë)

Bashkia Kavajë, falë pozitës gjeografike dhe klimës mesdhetare shumë të avantazhuar, përfshin në vetvete jo vetëm potenciale gjeografike dhe natyrore, por dhe shumë pika historike dhe turistike siç janë:

- Kalaja e Zik- Xhafaj
- Kalaja e Turrës
- Kulla e Sahatit (1817)
- Ura e Bukaqit (në shek. XVIII-të)
- Kisha e Shën Premtes, Çetë (1280)
- Ndërtesa e Muzeut Etnografik (në fundin e shek. XVII-të)
- Banesa Haxhi Alushi
- Banesa Haxhi Myftari
- Banesa Man Kashami
- Banesa Bajram Xhani
- Banesa Kadri Xhafa
- Banesa Bardhyl Gorani
- Ndërtesa e Bashkisë Kavajë

## 4.2 Problematikat Mjedisore dhe Gjendja Aktuale

Aktualisht, zona e projektit (ish reparti ushtarak), e cila ndodhet në menaxhim dhe përdorim nga pushteti vendor, si pasojë e keqmenaxhimit të deritanishëm, si dhe e papërgjegjshmërisë së qytetarëve të ndryshëm, ka sjell degradimin e tij në vendgrumbullim të materialeve inerte e jo vetem. Gjithashtu, përdorimi i disa objekteve si vendbanim nga disa banorë jo rezidentë, duke mos përmbushur asnjë kusht minimal jetese, e ka kthyer këtë hapësirë në burim potencial për përhapjen e viruseve dhe epidemive të ndryshme me pasojë direkte në shëndetin e banorëve, ndihmuar edhe nga mungesa e kanalizimeve të ujërave të bardha e të zeza.





p  
Pro  
AI



Open



### 4.3 Analiza e Elementeve të Fortë Territorial SWOT

<p style="text-align: center;"><b>Pikat e Forta</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pozicion gjeografik i favorshëm, vendndodhja në qendër të qytetit.</li> <li>• Akses i lehtë si rrjedhojë e shtrirjes së tij përgjatë unazës perëndimore të qytetit.</li> <li>• Pronësi publike në përdorim dhe menaxhim të organeve lokale.</li> <li>•</li> </ul>	<p style="text-align: center;"><b>Pikat e Dobëta</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjendja e objekteve aktuale</li> <li>• Okupimi i ambjenteve aktuale nga banorë të komunitetit Egjiptian</li> <li>• Shndërrimi i objekteve në vatra potenciale për sëmundje të ndryshme</li> <li>• Mungesa e kanalizimeve të ujërave të bardha e të zeza</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>Mundësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i hapësirave të gjelbërta</li> <li>• Krijimi i hapësirave socializuese</li> <li>• Krijimi i këndeve sportive</li> <li>• Rivitalizimi i hapësirave të abandonuara</li> <li>• Ndikimi pozitiv në reduktimin e ndotjes së ajrit.</li> <li>• Rigjallërimi i jetës komunitare</li> </ul>	<p style="text-align: center;"><b>Kërcënimet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shndërrimi i zonës në vendgrumbullim të materialeve inerte</li> <li>• Shndërrimi i zonës në një hapësirë të pasigurt për komunitetin</li> </ul>

## 5. AKSESUESHMËRIA

Vendodhja e Parkut të propozuar, duke qenë përgjatë unazës perëndimore të qytetit (Rruga Taulantia, mbi të cilën dikur kalonte ish rruga nacionale), ka avantazhin të përfitojë nga potenciali i kësaj linje rrugore. Në të shkuarën, unaza e qytetit kryente rolin e rrugës nacionale, por me ndërtimin e autostradës Durrës-Rrogozhinë, ndryshoi edhe roli i unazës nga një rrugë inter-urbane, në një rrugë të mirëfilltë urbane. Pavarësisht se ky ndryshim ndikoi ndjeshëm në reduktimin e qarkullimit rrugor dhe rrjedhimisht në uljen e potencialit ekonomik të këtij aksi rrugor, në këmbim qytetit iu zbut barriera që krijonte ish rruga nacionale, duke i integruar zonat dhe distriktet (lagjet) që kjo barriera ndante. Pra, në një këndvështrim më të gjerë, shndërrimi i unazës nga një rrugë me karakter kryesisht inter-urban në një rrugë të mirëfilltë urbane, ndikoi pozitivisht në lidhjen urbane të qytetit.

Aspekti ekonomik është temë për debat në këtë rast, sepse vetë dinamika e zhvillimit ekonomik të qytetit lidhet më së shumti me faktorë të jashtëm dhe ka nevojë për një studim më të hollësishëm të këtij aspekti, pasi transporti nuk është i vetmi faktor. Por vlen të theksohet se në një këndvështrim më të plotë, në aspektin urban, unaza si një nga akset më të rëndësishme të qytetit, i dyti për nga rëndësia për qytetin e Kavajës, ka potencial jo vetëm në rritjen e aksesit ndërmjet zonave (lagjeve) me njëra-tjetrën, por edhe në lidhjen e qytetit me qytezat dhe fshatrat përreth (Karpen, Qerret, Synej, Golem, Mali I Robit , etj) që ky “hinterland” mbulon. Konkretisht, në funksion janë linja urbane Kavajë-Golem, e cila më parë mbulohej nga linja inter-urbane Kavajë - Durrës. Gjithashtu, vlen të përmendet që unaza përdoret si linjë tranziti nëpërmjet disa prej fshatrave dhe qytezave të lartpërmendura dhe qyteteve të Durrësit dhe Tiranës kryesisht. Shkurtimisht, duke theksuar

rëndësinë e Unazës së qytetit (Rr. Taulantia) në qasje me Parkun e propozuar tek Ish Ushtria, me optimizmin që ky aks të mos shërbejë thjesht si linjë tranziti, por duke u bashkërenduar me projekte social-kulturore, të nxisë projekte të mëtejshme në shërbim të jetës qytetare të Kavajës, të rrethinave dhe jo vetem.

Përpos qasjeve të lartpërmendura, në një kënvështrim akoma më të gjerë urban, projekte të këtij lloji, të vendosura përgjate akseve kryesore, të shërbejnë për të zbutur barrierën që unaza, si një element i theksuar urban, krijon ndërmjet qendrës së qytetit dhe periferive si dhe të përmbushin funksionin social-ekonomik që karakterizon cdo ambjent urban në vetvete. Nga ana tjetër, nëse e shqyrtojmë projektin e propozuar te parkut nga një qasje në shkallë më të vogël urbane, planvendosja e projektit, e ndodhur mbi kryqëzimin midis Rrugës Taulantia (unazës perendimore të qytetit) dhe Rrugës Qazim Kariqi, e cila është edhe një nga dy akset transversal më të rëndësishëm të qytetit, ka një pozicion tepër strategjik. Mjafton të përmendim faktin që planvendosja e projektit mbi zonën e ish repartit ushtarak, për të vënë në pah vendosjen optimale në raport me rrugët, dhe rrjedhimisht me infrastrukturën, duke pasur parasysh edhe faktin që në planifikimet rajonale dhe urbane të sistemeve të shkuara totalitare (Monarkia, Pushtimi Fashist dhe Diktatura Komuniste), zonat militare pozicionoheshin në zonat më strategjike në raport me rrugët dhe infrastrukturën, sidomos në rastet kur një repart i këtyre përmasave vendosej në një hapësirë urbane. Megjithëse zona e caktuar për projektin e Rivitalizimit të Zonës Ish-Ushtria në Park Kreativ përfshin vetëm një pjesë (1/3 e sipërfaqjes) të ish repartit ushtarak, planvendosja e kësaj zone të caktuar ka pozicionimin më të aksesueshëm urban në krahasim me zonën e mbetur të ish ushtrisë, e cila nuk përfshihet në projekt. Vendndodhja e stacionit të furgonave në kryqëzimin në fjalë, është një faktor i rëndësishëm në aksesueshmërinë e parkut, që mundëson transport të drejtpërdrejtë si urban, ashtu edhe inter-urban.

### **5.1 Lidhja Infrastrukturore dhe Transporti Publik**

Siç u përmënd më lart, projekti i Rivitalizimit të Zonës Ish-Ushtria në Park Kreativ ka pozicion strategjik në raport me infrastrukturen dhe transportin publik. Rruga Taulantia apo unaza e qytetit, me gjerësi 10,5 m, e shtruar me asfalt, është karexhatë me dy sense, dhe një korsi parkimi. Rruga ka trotuar nga të dyja anët me gjerësi që varjojnë në jo më shumë se 2 m. Në kryqëzim me këtë rrugë është rruga Qazim Kariqi, vazhdimësi e njërit prej dy akseve transverasale rrugore që dalin nga qendra e qytetit, aktualisht është rreth 7m e gjerë me kanal kullues të hapur nga njëra anë, dhe trotuar të shtruar vende-vende në krahun tjetër dhe nuk ka vend-korsi për parkim. Për sa i përket transportit publik, ashtu sikurse u përmënd më lart, vendndodhja e stacionit të furgonave në anën tjetër të kryqëzimit, midis rrugës Taulantia dhe Qazim Kariqi, ku edhe kryqëzohet rruga Jurgen Trade (me gjerësi 8 m dhe me një korsi parkim, ka trotuar me gjerësi që varjon 1m deri në 3m) që vjen nga qendra e qytetit, krijon potencial që parku i projektuar të aksesohet jo vetëm nga banorë të qytetit, por edhe nga periferitë dhe rrethinat. Gjithashtu, afërsia me qendrën e qytetit, duke pasur parasysh faktin që vizitorët dhe turistët me transport publik apo privat, përdorin qendrën e qytetit si vendqëndrim, është një potencial po i rëndësishëm për parkun.

Zona e projektit të propozuar nuk ka dalje direkte në rrugën Qazim Kariqi, por krijon lidhje me zonën në fjalë nëpërmjet rrugës Taulantia, dhe rrugës Ceno Kavaja (kjo e fundit kryqëzohet me rr. Qazim Kariqi në kthesën e Spitalit të ri dhe përshkron bllokun e banesave sociale në formën e gjysëm unazës duke krijuar dalje në rrugën Taulantia). Në mënyrë të tërthortë, duke përshruar bllokun e banesave sociale, hyrja perendimore e projektit të parkut (e cila është dhe hyrje

ekzistuese) lidhet pikërisht me rrugën Ceno Kavaja. Nga ana tjetër, hyrja nga ana lindore e projektit, e cila gjithashtu është edhe hyrje ekzistuese, ka dalje direkte në rrugën Taulantia apo unazën e qyteti, dhe aksi pedonal brenda projektit të parkut, përgjatë segmentit më të shkurtër midis dy hyrjeve, lidh pikërisht këtë rrugë me bllokun e banesave sociale që vendndodhet në perëndim të zonës së projektit të parkut, duke mundësuar kështu edhe qarkullim këmbësor indirekt në formën e “shortcut” për banorët e këtij blloku banimi. Faktikisht, pozicionim i hyrjeve në projekt duke mbajtur vendosjen ekzistuese, ruajti kontekstin e pëlhurës urbane dhe rrjedhimisht supozohet që në qasjen e projektimit, aksi kryesor pedonal brenda parkut, duke i dhënë një formë më të zhvendosur drejt veriut dhe me kthesë me kënd drejt perëndimit, të ketë edhe trajtë shëtitëse duke i nxitur banorët e zonave përreth që të mos e përdorin thjesht për rrugë të shkurtër (si “shortcut”) këtë segment pedonal brenda projektit të parkut.

Ideja e projektimit të parkut është pikërisht principi që ky park të jetë sa më tërheqës, prandaj dhe hierarkia e akseve dhe segmenteve pedonale brenda parkut sugjeron aksesin e tërthortë dhe shëtitës në një mënyrë të tillë qarkullimi, që këmbësori apo përdoruesi, të ndjekë rrugën në bazë të qëllimit që ka në momentin që akseson parkut. Më konkretisht, nëse një përdorues, ka për qëllim që thjeshtë të përshkojë parkun thjeshtë për shkurtim rruge midis distriktive të qytetit, le të ndjekë aksin e pedonalës dytësore, që është edhe aksi direkt midis dy hyrjeve të parkut. Por, duke pasur parasysh dhe principin e lartpërmendur, ky aks dytësor, nga shkalla hiarkike, është vetëm 1.8 m i gjërë, dhe në krahasim me aksin kryesor pedonal, që është 5 m i gjerë, i sugjeron përdoruesit që të zgjedhi në bazë të synimit që përdoruesi në fjalë ka. Pra, një përdorues, ka dy zgjedhje për llojin aktivitetit që ka synim, nëse kemi parasysh dhe shtigjet tretësore të projektuara për parkun, njëra zgjedhje është thjesht aksesueshmëria, ndërsa tjetra është aktiviteti shëtitës, që në qasjen e projektimit është dhe aktiviteti më i rëndësishëm, pra dhe gjerësia e aksit kryesor pedonal me gjerësi 5 m, dhe në formën e unazës që përshkon perimetrin e projektit, është paramenduar për këtë qëllim. Për ta baraspeshuar, aksesin direkt është projektuar në linja dhe akse dytësore. Gjithashtu, janë projektuar dhe linja tretësore (me gjerësi 1.6 m) që kanë karakter shëtitës, të cilat, si element projektimi, plotësojnë funksionimin e lëndinës së piknikut, kopështin e trëndafilave dhe këndit sportiv.

Përveç akseve pedonale, janë projektuar dhe pista e vrapimit dhe korsa e biçikletave, të cilat kanë formën e unazës, por në ndryshim nga unaza e aksit pedonal kryesor, këto dy elementë krijojnë kryqëzime për ta përshkuar parkun jo vetëm në perimetër, por edhe në brendësi dhe janë projektuar me qëllim tërësisht rekreativ, pra në aspektin e aksesueshmërisë nuk sugjerojnë thjesht aktivitet qarkullues. Më konkretisht, nuk supozohet që një përdorues biçiklete ose (vrapues) të përdorë këto funksione të projektit të parkut thjesht për tranzit ndërmjet dy lagjeve të qytetit.

Për ta përmbledhur, aksesin e parkut nëpërmjet infrastrukturës dhe transportit publik, duke pasur parasysh potencialin e pozicionit të planvendosjes së projektit, është paramenduar që të funksionojnë për ta ushqyer parkun dhe jo anasjelltas. Pra, parku do të ketë akses ekskluzivisht pedonal, duke pasur një numër të kufizuar hyrjesh, qarkullimi rastësor për shkurtim rruge “shortcut” do të jetë i kufizuar dhe më i përdorshëm për banorët e bllokut të banesave sociale. Madje, edhe qarkullimi me biçikleta supozohet të jetë ekskluzivisht rekreativ.

## **5.2 Sistemi i Kanaleve Kulluese (dranazhimi)**

Pozicioni i planvendosjes përgjatë rrugës Taulantia ofron nga ana infrastrukturore dhe lidhjen me sistemin e UKK (Ujësjellës Kanalizime Kavajë), por duke qenë sipërfaqje e madhe, projekti i parkut ka nevojë për një sistem të mirëfilltë furnizimi dhe kanalizimesh, i cili paramendohet të



kryhet në dy faza. Duke pasur parasysh rrjetin ekzistues të kanalizimeve të kompleksit të ish repartit ushtarak, paramendohet të shfrytëzohet ky rrjet ekzistues, i cili konsiston në lugje të hapura kullimi me përmasa të prerjeve tërthore trapezoidale ( $a=80\text{cm}$ ,  $b=60\text{cm}$ ,  $h=50\text{cm}$ ) dhe përshkon zonën në fjalë në dy linja paralele dhe dy linja tërthore, të cilat kryqëzohen me njëra tjetrën. Duke qenë se rrjeti ekzistues është tërësisht i amortizuar, paramendohet që i njëjti sistem të kryhet nga e para mbi të njëjtën njollë, duke ruajtur kështu veçoritë ekzistuese të sistemit të kullimit. Ujrat e bardha paramendohet të shkorkohen në kolektorët e vendndodhura në bllokun e banesave sociale. Nëse do të gjykohet e arsyeshme, në një fazë të dytë mund të propozohet dhe vendosja e përshpejtuesve të kullimit në vendet ku është më e domosdoshme.

Duke pasur parasysh sipërfaqjen e madhe të projektit dhe domosdoshmërinë e vendosjes së shërbimeve (ËC-ve) në projekt, kanalizimi i ujrave të zeza është paramenduar nëpërmjet gropave septike. Kjo zgjidhje sugjerohet të jetë afat-shkurtër, sepse është në varësi të infrastrukturës së lagjeve kufitare me parkun (pasi është e nevojshme të kryhen punime të mëtejshme.)

### 5.3 Sistemi i Rrjetit Elektrik

Në afërsi të planvendosjes së projektit të parkut, gjenden pesë kabina shpërndarje me tension të ulët 220 Volt, nga të cilat, kabina 6/1 dhe 6/2 të cilat gjenden përgjatë rrugës Taulantia janë më të përshtatshme për lidhjen e sistemit të ndriçimit të parkut dhe impjantet e ndriçimit me rrjetin elektrik.

## 6. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I PARKUT

Funksionimi i Parkut Rekreativ është konceptuar si një kompleks që përfshin funksione me karakter atletik, sportiv, zbavitës dhe rekreativ për komunitetin, si dhe gjelbërimi është elementi më i theksuar, duke minimizuar kështu elementet urbane në maksimum. Shkurtimisht, parku si kompleks rekreativ, konsiston në dy kënde lorjash për fëmijë, një palestër të jashtme për grupmosha të ndryshme, një kompleks terreni sportiv, një kënd shahut (kryesisht për grupmoshën e tretë por jo vetëm) një shesh qendror të projektuar bashkë me basene uji, një kopësht trëndafilash, si dhe një kopësht botanik. Gjithashtu, si koncept projektimi, përfshihet edhe lëndina e gjelbër për piknik, e cila okupon një sipërfaqje të konsiderueshme të gjelbëruar me bar dhe pemë (të paracaktuara) midis baseneve ujore të sheshit qendror në perëndim dhe shtegut kryesor (parësor) në lindje. Pista e vrapit dhe korsa e biçikletës, si objekte infrastrukture në brendësi të parkut, janë në vetvete funksione me karakter atletik dhe rekreativ. Si konceptim projektimi, të gjitha funksionet e lartpërmenduar, janë planvendosur duke marrë për bazë shtegun kryesor (që është aksi kryesor pedonal në formë unaze) dhe shpërndarja është konceptuar duke marrë parasysh stimuj paraprake të frekuentimit të zonave, si dhe duke iu referuar akteve pedonale kryesore dhe dytësore. Akset tretësore janë projektuar për t'u ndërthurur me këto funksione (si në rastin e palestrës së jashtme, terrenit sportiv, kopështit të trëndafilave, lëndinës së piknikut dhe baseneve ujore). Si funksione plotësuese të funksioneve të këtij parku rekreativ, janë paramenduar edhe dy zona shërbimesh (eko-kafene dhe wc) me elementët përkatës (tavolina dhe stola), të cilat janë të planvendosura në kryqëzimet e akteve dytësore, vizualisht e jo të dukshme përgjatë aksit kryesor pedonal (shtegut kryesor).

Grupmosha, si faktor në organizimin e funksioneve, në raport me hapësirën, aktivitetin, si edhe me grupmoshat e tjera, është i rëndësishëm në përcaktimin e shpërndarjes së funksioneve dhe në

vendimarrjen gjatë procesit të projektimit. Duke qenë e domosdoshme që ky projekt parku t'i shërbejë të gjitha grupmoshave pa përjashtim, u është kushtuar rëndësi funksioneve që përfshijnë një seri grupmoshash, apo edhe integrojnë këto grupmosha, si dhe funksione që i shërbejnë një grupmoshe të caktuar dhe një aktiviteti të caktuar. Përfundimisht, pasi janë analizuar faktorët e grupmoshës, hapësirës dhe aktivitetit, janë përcaktuar dhe funksionet në bazë të raportit midis këtyre faktorëve.

Gjatë projektimit, u konsiderua e arsyeshme që parku të përmbajë kënde lojrash për fëmijë në dy planvendosje të ndryshme, njëri në veri-perëndim dhe tjetri në perëndim të parkut. Si bazë arsyetimi është mungesa e theksuar e këndeve të tilla në blloqet e banimeve në afërsi të parkut të propozuar, si dhe në lagjet e tjera të qytetit. Gjithashtu, për hir të aksesit dhe shpërndarjes në raport me bimësinë, përkundër vendosjes së një këndi të madh lojrash, u vendos që ky funksion të jetë i pranishëm në dy planvendosje të ndryshme, në mënyrë, që përveç kendvështrimit arkitektonik si funksion, të organizohet më mirë në bazë edhe të grupmoshave të përdoruesve. Njëkohësisht, duke i rrethuar këto kënde lojrash me sheshe rrethuese në forma harkore (apo organike) të plotësuar me elemente urban si stola dhe ndriçimi, përveç elementeve të peisazhit, krijohen hapësirat e nevojshme për prindërit dhe familjarët që të kontrollojnë situatën.

Në rastin e sheshit qëndror, koncepti qëndron në idenë e integritetit të një game të gjerë grupmoshash, për të përmbushur edhe qëllimin e socializimit që parku synon në vetvete, prandaj dhe planvendosja (fizikisht) në qendër të këtij sheshi krijon një pikë takimi midis përdoruesve të funksioneve të tjera si dhe në nivel rekreativ, bëhet pjesë e eventeve të ndryshme. Në qasjen arkitektonike, si element kryesor i këtij sheshi, është përdorur uji, për të krijuar edhe një ambjent sa më natyral me nderthurje edhe me peisazhin e gjelbër përreth. Gjithashtu, duke pasur parasysh edhe klimën e theksuar mesdhetare (subtropikale) dhe faktin që frekuentimi i parkut kulminon në verë, elementi i ujit është mëse i përshtatshëm për ta bërë edhe më tërheqës këtë funksion për përdoruesit (apo vizitorët).

Funksionet e tjera, si këndi i shahut, palestra e jashtme, kopështi i trëndafilave, kopështi botanik, terreni sportiv dhe zonat e shërbimeve, duke pasur edhe funksione apo aktivitete më specifike, dhe si objektiv, një përcaktim më të qartë përdoruesish, fizikisht janë planvendosur në bazë të fluksit të përdoruesve, duke shmangur kështu mundësinë që zona të caktuara të parkut të kenë propocion të lartë frekuentimi në raport me zonat e tjera. Gjithashtu, duke pasur parasysh edhe principet e përmendura në temën e aksesueshmërisë së relacionit, parku rekreativ, përveç përdoruesve lokal të qytetit të Kavajës dhe rrethinave, synon edhe tërheqjen e vizitorëve (të rastit), prandaj dhe organizimit të funksioneve i është kushtuar rëndësi përsa i përket pozicionimit në ndërthurje me segmentet pedonale kryesore dhe dytësore. Më konkretisht, funksionet më kryesore si këndet e lojrave për fëmijë janë vendosur përgjatë aksit të shtegut kryesor, ndërsa sheshi qëndror me basenet ujore integrohet me segmentin më të rëndësishëm të akseve dytësore. Njëkohësisht, prezantimi i ujit si element peisazhi në sheshin qëndror, shërben edhe si element urban (landmark), duke përmbushur kështu edhe synimin tërheqës ndaj përdoruesve.

Të dhëna më të detajuara teknike të funksionimit të Parkut Rekreativ shtjellohen si më poshtë;

## 6.1 Këndet e lojrave për fëmijë

Ky funksion është ndarë në dy planvendosje dhe secili kënd është trajtuar me karakteristika të ngjashme arkitektonike e peisazhi në projekt, për t'iu përmbajtur kështu dhe principit të funksionit përkatës.

### a. Këndi i madh i lojrave për fëmijë

I planvendosur në veri-perëndim të parkut, këndi i madh i lojrave për fëmijë zë një sipërfaqje prej 958 m<sup>2</sup>, i cili synon grupmoshat nga 6 deri në 14 vjeç dhe përbëhet nga nën-ndarje të artikuluar me lodra fikse, si dhe me materiale të ndryshme ndërtimi. Veçoritë arkitektonike karakterizojnë këto nën-ndarje si më poshtë:

- Sheshi rrethues i këndit të lojrave i shtruar me beton të derdhur në vend dhe dekori i shtresës në sipërfaqje të punohet me shabllone të caktuar në bazë të projektit. Aplikohet mbushje çakulli mbi dhé të ngjeshur. Mobilimi urban përmban stola dhe shtylla ndriçimi. Sipërfaqja e tij arrin 500 m<sup>2</sup>.
- Shesh lojrash me beton të derdhur në vend, e lyster me bojë bi-karbonat me ngjyra të ndryshme. Aplikohet mbushje me çakull mbi dhé të ngjeshur. Mobilimi urban përfshin lodra të lëvizshme dhe jo të përhershme. Sipërfaqja arrin 140 m<sup>2</sup>.
- Shesh lojrash i shtruar me tartan apo gominë mbi shtresën e betonit të varfër. Mobilimi me lodra fikse të tipologjisë: kolovajzë (me strukturë metalike dhe druri). Aplikohet mbushje çakulli mbi dhé të ngjeshur.
- Shesh lojrash i mbushur me rërë të imët mbi dhé të ngjeshur. Mobilimi me lodra fikse të tipologjisë; kryesisht rrëshqitëse (me strukturë metalike dhe materiale PVC-je dhe fibrash xhami me ngjyra të ndryshme)

### b. Këndi i vogël i lojrave për fëmijë

Propozimi i këtij këndi, me sipërfaqe totale prej 640 m<sup>2</sup> erdhi si rezultat i konkluzioneve të nxjerra gjatë fazës së analizave mbi domosdoshmërinë e një këndi të dytë lodrash në projekt. Planvendosja u caktua në zonën perëndimore të projektit të parkut, përgjatë segmentit të aksit kryesor, pranë edhe hyrjes perëndimore. Ky kënd synon grypmoshë më të vogël, 3 deri në 7 vjeç, dhe, sikurse në këndin e madh të lojrave përfshin shesh rrethues të mobiluar me stola dhe shtylla ndriçimi, si dhe me elementë peisazhi të ngjashëm. Veçoritë arkitektonike karakterizojnë këtë kënd si më poshtë:

- Shesh rrethues i këndit të vogël të lojrave i shtruar me beton të derdhur në vend dhe dekori i shtresës së sipërfaqjes të punohet me shabllone të përcaktuar në bazë të projektit. Aplikohet mbushje me çakull mbi dhé të ngjeshur. Mobilimi urban përmban stola dhe shtylla ndriçimi. Sipërfaqja: 394 m<sup>2</sup>
- Shesh lojrash për fëmijë të grupmoshës 3 deri në 7 vjeç. Mbushje me rërë mbi dhé të ngjeshur. Mobilimi me lodra fikse të tipologjisë: rrëshqitëse (strukturë PVC-je dhe fibrash xhami me ngjyra të ndryshme) Sipërfaqja: 246 m<sup>2</sup>. (Fig.4)



Fig.4 Prerje montazh e këndeve të lojrave.

## 6.2 Sheshi qëndror me basenet ujore

Domosdoshmëria e një atraksioni qëndror të projektit të parkut, për të përmbushur jo vetëm qëllimin që një kompleks i tillë rekreativ ka në vetvete, por edhe për të pasur një pikë referimi (landmark) është plotësuar nëpërmjet elementit të ujit, i cili, në projektin e propozuar është edhe elementi më dominant i sheshit, duke u integruar më së miri me peisazhin e gjelbëruar përreth.(Fig.5)



Fig. 5 Pamje montazh i sheshit qëndror dhe baseneve ujore.

Sheshi qëndror së bashku me sipërfaqjen ujore arrin në një sipërfaqje totale prej 1226,3 m<sup>2</sup>, nga e cila 426.3 m<sup>2</sup> është sipërfaqe uji, pra me një raport të përafërt ½. Veçoritë teknike karakterizojnë këtë shesh si më poshtë:

a. Sheshi qëndror

Sheshi qëndror të jetë i shtruar me pllaka granili mat kundra-rrëshqitjes. Së pari aplikohet mbushje çakulli mbi dhé të ngjeshur, hidhet beton i varfër për të shtruar dy shtresa hidroizolim dhe më pas rrafshohet me rërë-çimento si bazë për ngjitje me koll të pllakave. Sipërfaqja: 800 m<sup>2</sup>

b. Basenet ujore

- Basenet ujore, në vetvetë është një sistemi i mirëfilltë inxhinierik dhe arkitektonik ndërtimi që funksionon nëpërmjet impianteve. Sipërfaqje ujore është ndarë në dy basene; një basen i madh në veri-perëndim me sipërfaqje 295,3 m<sup>2</sup> dhe një basen i vogël në jug-lindje me sipërfaqje 131m<sup>2</sup>. Së bashku me basenet ujore, është parashikuar në projekt edhe sistemi i shatërvaneve. Pavarasisht se janë dy objekte të veçanta, dhomat teknike dhe depozitat e ujit janë projektuar në mënyrë të tillë që e njejta strukturë ndërtimi t'i shërbejë të dy baseneve. Kjo strukture është e planvendosur nëntokë deri në kuotën -3,00 m dhe përfshinë zonën midis dy baseneve. Aksesi sigurohet nëpërmjet baxhave që kanë dalje në sheshin qëndror. Veçoritë më të detajuara arkitektonike dhe inxhinierike të baseneve ujore vijojnë si më poshtë;
- Depozita kompensimi të nivelit të ujit të baseneve; 2 njësi me nga 14 m<sup>2</sup> secila. Njëra e planvendosur në veri dhe ndan një segment muri me basenin e madh, ndërsa tjetra është e planvendosur në jug dhe ndan një segment muri me basenin e vogël. Kjo lloj vendosje është kusht I domosdoshëm për të siguruar daljen dhe lidhjen me tubacionet e nevojshme për mirëfunksionimin e impjantit. Struktura e karabinasë përbëhet nga pllakë themeli me trashësi 30cm, mure perde me trashësi 25 cm dhe soletë betoni 20 cm. Veshja e brendshme të jetë me qeramikë me përmasa 33x33x1cm. Hidroizolimi aplikohet pas shtresës së varfër të rrafshimit për themelin, si edhe mbas hedhjes së themelit. Përpara hedhjes së betonit të murit perde mbi pllakën e themelit, aplikohet gominë hidro-izoluese.
- Dhoma teknike, me sipërfaqe 71,5 m<sup>2</sup>, është pozicionuar ndërmjet dy baseneve me mure të përbashkët për të lehtësuar daljen e tubacioneve të furnizimit dhe shkarkimit të impiantit, si dhe duke gjykuar afërsinë që kanë dy basenet me njëra tjetrën, një dhomë teknike është e majftueshme për t'i shërbyer të dy baseneve njëkohësisht. Në projekt janë parashikuar 4 njësi pompa 3,5 KW për furnizimin e basenev me ujë, nga dy njësi për secilin basen,dhe dy njësi pompa 5,5KW për funksionimin e tre njësi sprucatorë shatërvani në basenin e madh, dhe dy njësi sprucatorë shatërvani në basenin e vogël. Secili sistem shatërvani funksionon nëpërmjet një pompe. Në zbatim të projektit, veçori teknike të pompave si fuqia apo lloji, janë për t'u rishikuar në bazë të projektit elektrik dhe mekanik. Gjithashtu, sasia në njësi e filtrave të parashikuar në projekt duhet të shqyrtohet. Për momentin janë parashikuar 4 njësi filtra me diametër Ø1200, nga dy njësi për secilin basen. Struktura e karabinasë përbëhet nga pllakë themeli me trashësi 30cm, mure perde me trashësi 25 cm dhe soletë betoni 20 cm. Veshja e brendshme të jetë me qeramikë me përmasa 33x33x1cm. Hidroizolimi aplikohet pas shtresës së varfër të rrafshimit për themelin, si edhe mbas hedhjes së themelit. Përpara hedhjes së betonit të murit perde mbi pllakën e themelit, aplikohet gominë hidroizoluese.

- Teknikisht, të dy basenet ujore kanë strukturë të njëjtë, nga ku ndryshimi i vetëm janë përmasat; baseni i madh ka sipërfaqe prej 295,3 m<sup>2</sup> sipërfaqe uji, ndërsa i vogli ka sipërfaqe 131 m<sup>2</sup>. Detyrimisht edhe përmbajtja sasiore e materialeve është në proporcion me sipërfaqen. Struktura e karabinasë përbëhet nga pllakë themeli me trashësi 30cm, mure perde me trashësi 25 cm dhe mbi muret perde, me beton të derdhur në vend dhe do të mbivendosen bordura me gjerësi 40cm, lartësi 20cm dhe gjatësi, të cilat variojnë në baze të skicave të projektit. Mbi këto bordura, në projekt, janë parashikuar të aplikohen ristela druri që do të kryejnë rolin e ndjenjësve për tu ulur. Tabani, sipërfaqja e brendshme e mureve, si dhe pjesa e zbuluar e mureve perde në shesh, në projekt, janë parashikuar të vishen me shtresë pllake graniti multi-kolor me përmasa 12,5x25x0,9 cm. Hidroizolimi aplikohet pas shtresës së varfër të rrafshimit për themelin, si edhe pas hedhjes së themelit. Përpara hedhjes së betonit të murit perde mbi pllakën e themelit, aplikohet gominë hidroizoluese.
- Ndryshimi i baseneve ka si qëllim, jo vetëm ndryshimin, por edhe estetikën e sheshit gjatë mbrëmjes. Në projekt janë parashikuar 14 njësi shtylla ndryshimi h=2 m . Baseni i madh përmban 28 njësi ndryshues in-kaso në kuotë nën nivelin e ujit, ndërsa baseni i vogël përmban 14 njësi të tilla.

### 6.3 Lëndina e piknikut

Lëndina e piknikut është projektuar si funksion kryesisht nëpërmjet elementëve të peisazhit. Qëllimisht, në projekt hapësira midis segmentit lindor të shtegut kryesor dhe baseneve ujore në perëndim është përcaktuar të gjelbërohet kryesisht me bar natyral, dhe fizikisht në mes të mbillen një grup pemësh sipas një rendi apo rreshtimi radial për të krijuar idenë e korijeve në natyrë dhe për ta riprodhuar këtë lloj peisazhi pikërisht duke i ofruar përdoruesve zgjedhje midis hapësirës së hapur të gjelbër dhe hapësirës të dendur të përkufizuar nga kurorat e pemëve. I vetmi element urban është një segment shtegu tretësor (pavarsisht se proporcionalisht ky shteg është vetëm 1,6 m i gjerë dhe përbëhet nga blloqe guri 4 rreshta nga 40x40x5cm), i cili përshkon këtë hapësirë përmes pemëve si dhe përmes sipërfaqes së mbjellë vetëm me bar, duke krijuar akses nga shtegu kryesor dhe sheshi qendror i baseneve të ujit.(Fig.6)



Fig.6 Pamje montazh e shtegut tretësor që përshkon lëndinën e piknikun.

## 6.4 Pista e Vrapimit

Pista e Vrapimit është trajtuar në projekt më një formë organike si kundrapeshë e formave më konvencionale të përdorura në shtigjet (parësore dhe dytësore), si edhe në korsinë e biçikletave. Një zgjedhje e tillë është edhe me qëllimin që korsia e vrapimit, të përceptohet nga përdoruesi si një funksion më dinamik në lidhje edhe me peisazhin. Perimetri i kësaj piste është i mbyllur, me idenë që përdoruesit, pra vrapuesit dhe atletët, t'i ndihmojë në përcaktimin e numrit të xhirove gjatë aktivitetit që ata kryejnë. Pista është 931 metra linear dhe 2 metra e gjerë. Shtrimi është projektuar të jetë me tartan mbi beton të derdhur në vend . Mbi dhë të skarifikuar të aplikohet mbushje me çakull. Duke gjykuar që shtrimi me bordurë nuk ndikon në strukturën e kësaj piste, në projekt, shtrimi me bordure në dy anët e pistës është anashkaluar si proces edhe për qëllimin e zvogëlimit të kostove. Gjithashtu, duke pasur parasysh

që në mungesë të bordurave, çakulli do të jetë i dukshëm në dy anët e pistës, duke i krijuar edhe një përcaktim më natyral midis gjelbërimit me bar dhe shtresës me tartan të pistës.

## 6.5 Korsia e biçikletave

Korsia e biçikletave, sikurse pista e vrapit, është konceptuar si funksion kreativ në radhë të parë, pra , synimi është që përdoruesve t'i ofrohet një hapësirë për shëtitje në hapësirë dhe shijuar peisazhin, se sa të veprojë si një infrastrukturë rrugore e destinuar thjesht për qarkullim. Edhe projektimi I kësaj korsie me me perimetër të mbullur përcakton pikërisht këtë concept. Kjo korsi, është 840 ml e gjatë me gjerësi 2,6 m. Materiali i përdorur të jetë asfalt. Mbi dhë të skarifikuar të aplikohet mbushje me çakull. Nuk është parashikuar shtrim me bordura. Vendimi i këtillë është i njëjtë me arsyetimin e lartpërmendur në pikën 4 të relacionit.





Fig.7 Prerje tërthore e pistës

Fig.8 Prerje tërthore e korsisë së biçikletave



## 6.6 Kopështi i trëndafilave

Kopështi i trëndafilave është vendosur në projekt përgjatë njërit segment të akseve dytësore, që degëzohet nga shtegu kryesor në perëndim dhe kryqëzohet me segmentet e tjera dytësore në veri të baseneve ujore. Duke qenë se ky segment ndodhet përgjatë boshtit që lidh dy hyrjet e parkut, u konsiderua e rëndësishme, që hyrja e perëndimit, nga blloku i banesave sociale, të ketë kualitete të veçanta të peisazhit, si edhe të veprojë si një hapësirë për aktivitete të llojit “event” (apo edhe më specifik si .p.sh. ceremoni zyrtare martesore) . Propozimi i vendosjes së një pavilioni me material hekuri, ka si qëllim të shërbejë në funksion të përdoruesve dhe aktiviteteve më spontane rekreative. Sipërfaqja e mbjellë me rrënjë trëndafilash është 2300 m<sup>2</sup> , e përkthyer në rreth 1200 rrënjë trëndafilash, ndërsa sheshi i destinuar për “evente” përfshin 120 m<sup>2</sup>, pra në total, ky funksion zë 730 m<sup>2</sup>. Shtrimi i korridoreve ndërmjet rreshtave të trëndafilave propozohet të bëhet me pllaka guri 40x40x5 cm, të rreshtuar për 4 dhe të kompozuar përgjatë gjith aksit me fuga 5-8 cm nga njëra tjetra. (Fig.9)

Shumë pranë kopështit të trëndafilave, shtrihet bukur një lëndinë e pozicionuar në mes dy hapësirash të rëndësishme të parkut sic është sheshi qëndror me basenet ujore dhe këndi i lojërave për fëmijë. Pikërisht në këtë hapësirë janë parashikuar katër pergola me material druri të cilat do të shërbejnë si pikë atraksioni si dhe si hapësira pushimi për përdoruesit e kësaj hapësire.




Fig.9 Prerje përgjatë rreshtave të mbjellë me trëndafila

## 6.7 Terreni sportiv

Terreni sportiv është pozicionuar në jug perëndim të projektit të parkut, qoftë për arsye afrimiteti me fushën e sportit, që është një hapësirë kufitare me zonën jugore të parkut , e cila, ndonëse nuk është pjesë e projektit, është marrë parasysh si faktor i jatshtëm i rëndësishëm, qoftë edhe nga këndvështrimi planifikues. Bimësia, në kufij midis pronës së projektit të parkut dhe fushës së sportit, është trajtuar me bimësi me dendësi të rrallë dhe me numër të kufizuar rrënjësh, për të ruajtur kumunikim vizual me fushën. Aksesit midis parkut dhe fushës së sportit është neglizhuar, për arsye që kanë të bëjnë më sigurinë e parkut gjatë natës. Më në perëndim, nga planvendosja e pronës së projektit, terreni ka formë të thyer drejtëkëndore, duke krijuar aneks drejt perëndimit. Terreni sportiv, megjithëse është midis kontureve më të rregullta drejtëkëndore, shton edhe frekuentimin e këtij aneksi, i cili me mospraninë e një funksioni të rëndësishëm siç është terreni sportiv, do të ishte një hapësirë qorre apo e vdekur, siç përkufizohet edhe në arkitekturë. (Fig.10)






Fig.10 Planimetri e pjesëshme e parkut mbi kompleksin e terrenit sportiv.

Specifikisht, terreni sportiv përbëhet nga 2 njësi fusha tenisi dhe 1 njësi fushë basketbolli. Arsyetimi pas këtij vendimi qëndron në faktin se, tenisi luhet maksimalisht nga 4 sportistë njëkohësisht dhe për të përballuar frekuentimin e këtij sporti, u gjykua e nevojshme të jenë dy fusha të tilla. Nga ana tjetër, loja e basketbollit përshin 10 sportistë dhe duke qenë se kjo lojë luhet edhe me një kosh në rastin se skuadrat përbëhen nga më pak sportistë, fusha e basketbollit në tërësinë e saj, lejon edhe më shumë se 10 sportistë që të luajnë njëkohësisht. Përmasat e këtyre fushave janë standarte dhe në projekt është parashikuar që bankinat rrethuese përreth fushave të jenë sa më të gjëra për t'i dhënë hapësirë përdoruesve edhe në aktivitete plotësuese, si nxemje etj. apo edhe thjesht le të jetë si hapësirë për spektatorë.

Më konkretisht, fusha e tenisit, me përmasa standarte 27x13 m plotësohet me shesh rrethues në formën e bankinës përreth perimetrit me gjerësi 4 m në gjatësi të fushës dhe 7 metra në gjerësi të fushës. Fusha e basketbollit, me përmasa standarte 28x15 m, plotësohet me shesh rrethues në formën e bankinës, me gjerësi 2 m përreth të gjithë perimetrit. Shtrimi i këtyre fushave është parashikuar të jetë me tartan mbi një shtresë betoni të përfocuar me zgarë hekuri  $\varnothing 70$ . Aplikohet mbushje me zhavorr mbi dhé të ngjeshur. Parapakisht, është i domosdoshëm konturimi me bordura të prefabrikuara në perimetër, ku gërmohet në kuotë më të ulët se kuota e dheut të ngjeshur, dhe pas mbushjes me zhavorr, hidhet në vend beton për fiksimin e bordurave. Si sipërfaqje, të dy fushat e tenisit bashkë, zënë 1722 m<sup>2</sup>, secila nga 861 m<sup>2</sup>, ndërsa fusha e basketbollit zë 670m<sup>2</sup>.

Përveç funksioneve që përmendëm më lart, pjesë e terrenit sportiv, është edhe një mini-shesh, i destinuar si vend-qëndrimi apo pushimi për përdoruesit e këtij funksioni dhe frekuentues të tjerë të parkut. Pra, në pak fjalë, të përmbushë synimin e socializimit apo edhe të integritit të grupmoshave, që parku, si kompleks rekreativ, ka në vetvete. Vendimi për prezantimin e këtij mini sheshi u mor në bazë të analizave të marrëdhënies grupmoshë-aktivitet dhe funksion. Planvendosja e këtij sheshi përkufizohet nga njëra nga fushat e tenisit dhe fusha e basketbollit, dhe si kualitet hapsinor ka shfrytëzuar këndin që formohet pikërisht nga kjo fushë tenisi me fushën e basketbollit, duke krijuar kështu dhe një marrëdhënie më të larmishme midis aktiviteteve. Shtrimi propozohet në projekt të bëhet me pllakë trotuari. Aplikohet mbushje me zhavorr mbi dhé të ngjeshur. Është i domosdoshëm konturimi me bordura në perimetër. Sipërfaqja e këtij sheshi është 364 m<sup>2</sup>.

Ndiçimi i terrenit sportiv, është parashikuar të mundësohet nëpërmjet 14 prozhektorëve standart për fushat e volejbollit dhe basketbollit, ndërsa ndriçimi i mini-sheshit dhe trotuarëve të aksesit të mundësohet nga shtyllave ndriçuese të tipit h=2 m dhe tipit h=3,5 m .

Terreni sportiv, duke përfshirë fushat sportive së bashku me sheshin dhe aksesin me trotuar ,zë një sipërfaqje në total prej 2947 m<sup>2</sup>.

## 6.8 Palestra në natyrë

Palestra në natyrë ose e jashtme, në krahasim me funksionet e tjera, ka një planvendosje më të veçuar. Duke u ndodhur në jug-lindje të projektit të parkut, palestra e jashtme ka formën e rregullt rrethore dhe përshkohet në skaj nga një segment tretësor me formë gjarpëruese, i cili krijon akses ndërmjet palestrës dhe shtegut kryesor (parësor), si dhe vazhdon për të krijuar një lidhje spontane me pistën e vrapimit. Vendimi i marrë gjatë fazës së projektimit për ta vendosur këtë funksion pikërisht në këtë pozicion, erdhi si rezultat i potencialit të hapësirës së krijuar ndërmjet shtegut kryesor dhe pistës së vrapimit. Kjo e fundit, duke pasur në vetvete formë organike, e përshkon paralelisht palestrën e jashtme në gjysëm-perimetër, duke e përkufizuar hapësirën dhe peisazhin që krijohet. Gjithashtu, është i rëndësishëm të përmendim efektin pozitiv që krijon komunikimi vizual midis përdoruesve të palestrës dhe vrapuesve. Pra, këto dy funksione, në momentin që janë në afërsi me njëri tjetrin, mund edhe të alternohen si aktivitete. (Fig.11)





Fig.11 Pamje dhe prerje e palestrës në natyrë.

Shtrimi i sipërfaqes së palestrës propozohet të bëhet me tartan mbi shtresën e betonit. Ngjyra e tartanit të jetë e ndryshme nga ajo e pistës së vrapimit. Më parë, mbi dhë të ngjeshur të aplikohet zhavorr, pastaj të derdhet beton në vend. Për mobilimin e palestrës paramendohet të pajiset me paralele, trarë gjimnastike, mekanizma me pedale për ushtime të ndryshme, si edhe struktura me litarë marinari. Karakteristika më të detajuara të këtyre strukturave janë për tu rishikuar, por në vija

të përgjithshme sugjerohet që këto pajisje të kenë strukturë metalike, duke pasur parasysh faktorin amortizues dhe mirëmbajtjen. Ndriçimi konsiston në shtylla  $h=2\text{m}$  dhe  $h=0.6\text{m}$ . Palestra ka një sipërfaqe totale prej  $280\text{ m}^2$ .

## 6.9 Këndi i shahut

Këndi i shahut, pavarësisht sipërfaqjes së vogël që zë në raport me funksionet e tjera të parkun, është një nga funksionet më të rëndësishëm të parkut. Duke gjykuar domosdoshmërinë që ka zona urbane e kavajës për hapësira rekreative për moshën e tretë (përveç nevojave të tjera), pasi u konturua gjelbërimi dhe pasi u shpërndanë funksionet dhe aktivitetet në projekt, duke identifikuar edhe zonat që janë më të qeta dhe të dendura me bimësi, dhe rrjedhimisht më të hijëzuar në raport me zonat e tjera, përgjatë një prej segmenteve të akseve pedonale dytëore, u propozua dhe planvendosja e këtij këndi. Për të ruajtur efektin natural që pemët e larta krijojnë mbi këtë hapësirë, si edhe përfshirjen fizike të këtyre pemëve pikërisht brenda kësaj hapësire, një platformë druri u projektua për të mundësuar funksionimin e aktiviteteve rekreative. (Fig.12)



Këndit të Shahut

Fig.  
12  
Planimetri i

Struktura e drurit do të jetë e përbërë nga trarë dhe restela druri të fiksuara më anë të pjastrave dhe profileve metalike L mbi pilota betoni të derdhur në vend. Fiksimi të kryhet nëpërmjet vidave dhe bulonave. Vendosja e ndjenjësve për tu ulur, të parafabrikuara, do të kryhen veçmas strukturës së platformës. Deturimisht, gjatë shtrimit të platformës, forma e kësaj të fundit do të pritet në bazë të formave rrethore që kanë elementët urban, si bordurat përreth trungjeve të pemëve. Mobilimi i kësaj platforme përfshin ndjenjëse për tu ulur të parafabrikuara, dhe shtylla ndriçimi të tipit  $h=2\text{ m}$  dhe  $h=0,6\text{ m}$ . Sipërfaqja totale e këtij këndi është  $185\text{ m}^2$ . (Fig.13)




Fig.13 Prerje e këndit të shahut

## 6.10 Shërbime

Shërbimet, konsistojnë në vendosjen e strukturave të përkohëshme të dy eko-kafëve, me sheshet përkatëse të përbëra nga platforma të njëjta me strukturën e këndit të shahut. Këto eko-kafë do të përfshijnë edhe wc publike. Në terrenin sportiv, është parashikuar gjithashtu një strukturë e përhershme që të funksionojë si dhomë zhveshje dhe wc, të cilat të jenë të ndara në gabina të veçanta për meshkuj dhe femra. Sipërfaqja e dy platformave mbi të cilat do funksionojnë këto shërbime është respektivisht 256 m<sup>2</sup> dhe 260m<sup>2</sup>. Gjatë projektimit të këtyre platformave janë marrë në konsideratë të njëjtat principe gjatë dizenjimit të këndit të shahut, duke integruar edhe këtu gjelbërimin me pemë me platformën, sikurse kuptohet nga ilustrimi. (Fig.14)




Fig.14 Planimetri objekti të shërbimeve

Duke qenë se në projekt, tipologjia e objekteve të eko-kafëve është përcaktuar të jetë strukturë e përkohshme e parafabrikuar me material druri dhe metali, pilota të thella 0,9 m betoni të derdhur në vend, duke qenë mëse të mjaftueshme për shtrimin e bazamentit të këtyre dy strukturave. (Fig.15)




Fig.15 Prerje detaji i platformës prej druri

## 6.11 Kopështi botanik

Kopështi botanik, si vendosje në projekt, është propozuar në veri-lindje të projektit, në afërsi të hyrjes. Princiipi është i ngjashëm me kopështin e trëndafilave, por në këtë rast kopështi nuk përshkrohet nga asnjë aks pedonal, sepse është konceptuar si një hapësirë më natyrale dhe, duke qenë se shtrihet relativisht në qendër të një sipërfaqje të madhe të gjelbëruar me bar, shtrimi me

çfarëdo lloj materiali është anashkualar. Në projekt është parashikuar mbjellje me shkurre dekorative. Numri i rrënjëvë është për t'u rishikuar. Ky kopësht mbulon një sipërfaqje nominale prej 690 m<sup>2</sup>.

## 7. TIPOLOGJIA E INFRASTRUKTURES RRUGORE

### 7.1 Rruga Kryesore

Projektimi i parkut mund të themi se nisi nga dizejnimi i shtegut kryesor, i cili u trajtua si elementi bazë në ndihmë të perceptimit të hapësirës së gjelbër. Si element bazë shërbyen gjurmët ekzistuese të ish repartit ushtarak, të cilat ishin projektuar për ta përshkruar hapësirën nëpërmjet një sistemi karteziar, nga ku, dy rrugë lineare nga lindja në perëndim dhe një në atë veri-jugore. Të njejtën gjë mund të themi edhe për vendosjen e godinave, vendosur në mënyrë të tillë që të kenë akses sa më të drejtpërdrejtë me rrugën. Kështu, duke patur parasysh nga ato që u thanë më lart, u bë një studim i hapësirës në varësi të flukseve. Ishin të gjitha këto që ndihmuan në krijimin e formës unazore që kjo rrugë ka, pikërisht për të arritur aksesueshmëri sa më të madhe të hapësirës së parkut. Përsa i përket të dhënave teknike mund të themi që kjo rrugë ka një gjatësi prej 832m dhe një gjerësi prej 5m. Përshkon të gjithë sipërfaqen e parkut dhe do të shërbejë për lëvizjen e njerëzve dhe pastrimin e territorit. Përbërësit e shtresave të kësaj rruge janë:

- Cakull 15cm
- Stabilizant 10cm
- Zgarë hekuri Ø10
- Beton M-200 me trashësi 15cm



Rruga do të ketë bordura betoni të parapërgatitura me permasa 15x25cm. Për të bërë largimin e ujrave nga rruga kryesore dhe nga sipërfaqet e tjera të parkut do të vendosen lugje b/a C37/45 parabolik tip 150 me gjatësi 5m, duke ruajtur edhe sistemin e vjetër të drenazimit. Përsa i përket rrjetit të ndriçimit, ai do të jetë i përbërë nga shtylla me lartësi 3.5m me ndriçues nga të dy anët. Rruga kryesore është projektuar e tillë për të mos lejuar qarkullimin e mjeteve, vetëm me përjashtim të rasteve emergjente si dhe mjeteve të pastrimit të tonazhit të ulët.

### 7.2 Rruga dytësore

Rruga dytësore u mendua si një tjetër rrjet i cili do të ndihmonte rrugën kryesore në një përjetim ndryshe të parkut, duke evidentuar gjithashtu faktin se edhe këtu ndiqet e njejtja llogjikë e sistemit karteziar, pra rrugë lineare. Përsa i përket të dhënave teknike mund të themi kjo rrugë ka një gjatësi prej 666m dhe një gjerësi prej 1.8m. Vlen për tu theksuar fakti që ky rrjet shërben për të bërë më të aksesueshme cdo zonë të parkut dhe për të kaluar në hapësira si këndi i lojrave për fëmijë, basenet ujore, këndi i shahut, terrenet sportive etj, aty ku nuk kalon rruga kryesore.

Përbërësit e shtresave të kësaj rruge janë:

- Cakull 15cm
- Pllaka granili me bojë

Rruga do të ketë bordura betoni 25x12cm të derdhura në vend.

### **7.3 Rruga tretësore**

Rrugët tretësore, përveç se janë ndihmesë e të gjithë sistemit rrugor të dizajnuar, kanë qëllim edhe lidhjen më të shkurtër të rrugëve me njëra-tjetrën, funksionet përbërëse të parkut me njëra-tjetrën, si dhe përshkrimin e një funksioni në të gjithë hapësirën. Përsa i përket të dhënave teknike mund të themi që kjo rrugë ka një gjatësi prej 380 m dhe gjerësi prej 1.6 m.

Perberesit e shtresave te ketyre rrugeve jane:

- Pllaka guri te vendosura direkt mbi terren me dimensione 40x50x5 cm

Rrugët tretësore dhe dytësore bëjnë të mundur qarkullimin në të gjitha pikat argëtuese të parkut, duke lënë të lira korsitë e biçikletave dhe të vrapimit.

### **7.4 Trajektorja e biçikletave**

Trajektorja e biçikletave u dizajnuar duke patur parasysh gjurmët e vjetra të godinave të ish repartit ushtarak, me linja të drejta por në formë unazore, e cila përshkon të gjithë parkun. Shëtitja në këtë trajektore bën të mundur një përjetim të plotë të parkut me të gjithë elementët përbërës të tij. Një trajektore e tillë është një element i domosdoshëm në park e gjithashtu në qytet. Edhe pse frekuentimi i biçikletës në qytet është i lartë vërehet një mungesë e theksuar e korsive të tilla. Në qytet gjendet vetëm një segment i tillë në rrugën dalëse në jug. Gjatësia e kësaj trajektoreje prej 840 m dhe gjërësi 2.6 m është më se e mjaftueshme për të plotësuar nevojat e të gjithë grupmoshave.

Përbërësit e shtresave të kësaj rruge janë:

- Shtresë çakulli me trashësi 15 cm
- Shtresë stabilizanti me trashësi 10 cm
- Shtresë binderi me zall lavatriçeje 6 cm
- Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçeje 4 cm

### **7.5 Trajektorja e vrapimit**

Korsia e vrapimit, ndryshe nga sistemi që është përdorur për të dizajnuar rrugët, ka një formë organike, e cila përshkon parkun në një sipërfaqe më të madhe, nga ku herë-herë përçan rrugën

kryesore, afrohet me korsinë e biçikletave, me funksionet përbërëse të parkut, duke ndjerë dhe shijuar gjelbërimin, duke ofruar vizualitet më të madh për vrapuesit dhe përjetim të plotë të parkut. Vlen për t'u theksuar fakti që kjo do të jetë korsia e parë e vrapimit në qytet.

Të dhënat teknike: Kjo trajektore ka një gjatësi prej 931 m dhe gjerësi 2m.

Përbërësit e shtresave të kësaj rruge janë:

- Shtresë çakulli me trashësi 15 cm
- Shtresë stabilizanti me trashësi 10 cm
- Shtresë binderi me zall lavatriçeje 6 cm
- Shtresë asfaltbetoni me zall lavatriçeje 4 cm

## 8. GJELBËRIMI DHE BIMËSIA

Një nga objektivat i këtij projekti është të sjellim natyrën sa më pranë qytetit e banorëve. Të prodhojmë oksigjen e të pakësojmë gazin karbonik i cili në dhjetëvjeçarin e fundit me rritjen e popullsisë dhe mjeteve motorrike ka arritur nivele të larta. Për këtë arsye, bimët në tërësi luajnë një rol të rëndësishëm në mjedis, në jetën e kafshëve dhe atë të njeriut. Ato gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e cilësisë hapësirë në hapësira publike.

Pas një studimi teknik të terrenit, kushteve natyrore, klimatike, ato të rilievit dhe të tokës, në këtë park rekreativ propozohet një bimësi e përshtatshme si;

- a. Pemë Gjethore (Angiosperms) të përhershme dhe gjetherënës
- b. Pemë Halore (Gymnosperms) të përhershme
- c. Shkurre
- d. Lule të ndryshme të stinës

Ndër pemët gjethore propozohen:

- *Laurus Nobilis*
- *Carpinus Betulus*
- *Tilia Cordata*
- *Platanus Orientalis*
- *Magnolia Grandiflora e Bardhe*
- *Magnolia Grandiflora Roze*
- *Prunus Cerasifera 'Pissardii'*
- *Prunus Sargentii*
- *Castanea Sativa*
- *Ginkgo Biloba*



- *Aser Compestre*
- *Quercus Palustris*
- *Quercus Rubra*
- *Quercus Ilex*
- *Salix Babylonica 'Aurea'*
- *Robina Pseudoacacia Fraisia*
- *Olea Europea*
- *Eucalyptus*
- *Liquidambar Stryraciflua*
- *Acer Cappadocium 'Aureum'*
- *Celtis Australis*

#### Tipi Shkurre

- *Ligustrum Ovalifolium*
- *Ligustrum Ovalifolium Aureum*
- *Buxus Sempervirens*
- *Acuba Japonica*

#### Ndër pemët Halore propozohen:

- *Pinus Pinea*
- *Pinus Sylvestris*
- *Pinus Halepensis*
- *Picea Abies*
- *Abies Alba*
- *Abies Balsamea*
- *Cedrus Atlantica 'Glauca'*
- *Cedrus Libani*
- *Cedrus Deodara*
- *Chamaecyparis Laësoniense 'Ellëoodii'*
- *Picea Pungens 'Glauca'*
- *Leyland Cypress*
- *Thuja Occidentalis*
- *Taxus Baccata 'Fatigiata Aurea'*



#### Bimësia e propozuar:

- *Trëndafila të llojeve të ndryshme.*
- *Lule të stinës si: Iris, Viola, Tulipa, Hyacinthus, Bellus, Gladiolus, Narcissus, Ranunculus, Camellia, Crocus.*

Për sa i përket veçorive të secilës pemë dhe bime, si dhe detaje të tjera ju lutem referojuni materialit të mëposhtëm. (Fig.16,17)

# LLOJET E BIMËSISË

## ANGIOSPERMS

	<p><b>Laurus Nobilis</b>                      Tipi: Pemë dhe Shkurre Aromatike                      Familja: Lauraceae                      Lartësia: Max 10 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme</p>		<p><b>Ginkgo Biloba</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Ginkgoaceae                      Lartësia: 20-35 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Duron temperaturat e ulta.                      Gjël bërimi: Gjetherënës                      Gjethet ndërrojnë ngjyrë në vjeshtë                      Optimale: Male Ginkgo Biloba</p>		<p><b>Eucalyptus</b>                      Tipi: Pemë                      Familja: Myrtaceae                      Lartësia: 10-60 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme</p>
	<p><b>Carpinus Betulus</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Betulaceae                      Lartësia: 15-25 m.                      Rritja Optimale: Zonë e ngrohtë/Hije                      Gjël bërimi: Gjysëm e përshshme</p>		<p><b>Aser Compestre</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Sapindaceae                      Lartësia: 15 - 25 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: Gjetherënës                      Në vjeshtë gjethet ndërrojnë ngjyrë në kuqe, portokalli ose të verdha.</p>		<p><b>Liquidambar Stryaciflua</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Altingiaceae                      Lartësia: 15 - 21 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: Gjetherënës                      Në vjeshtë gjethet ndërrojnë ngjyrë në kuqe, portokalli ose të verdha.</p>
	<p><b>Tilia Cordata</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Malvaceae                      Lartësia: 25-30 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Duron edhe thatësitë                      Gjël bërimi: Gjetherënës                      Gjethet ndërrojnë ngjyrë në vjeshtë</p>		<p><b>Quercus Palustris</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Fagaceae                      Lartësia: 18 - 22 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: Gjetherënës                      Gjethet ndërrojnë ngjyrë në vjeshtë</p>		<p><b>Acer Cappadocium 'Aureum'</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Sapindaceae                      Lartësia: 15 - 21 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell/Hije                      Gjël bërimi: Gjetherënës                      Në vjeshtë gjethet ndërrojnë ngjyrë</p>
	<p><b>Platanus Orientalis</b>                      Tipi: Pemë                      Familja: Platanaceae                      Lartësia: 5 - 30 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: Gjetherënës                      Në pranverë gjethet të verdha</p>		<p><b>Quercus Rubra</b>                      Tipi: Pemë                      Familja: Fagaceae                      Lartësia: 10-28 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: Gjetherënës                      Gjethet ndërrojnë ngjyrë në vjeshtë</p>		<p><b>Celtis Australis</b>                      Tipi: Pemë                      Familja: Cannabaceae                      Lartësia: 10-25 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: Gjetherënës</p>
	<p><b>Magnolia Grandiflora</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Magnoliaceae                      Lartësia: 8 - 30 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme                      Pemë me lule të mëdha me ngjyrë të bardha dhe rozë</p>		<p><b>Quercus Ilex</b>                      Tipi: Pemë                      Familja: Fagaceae                      Lartësia: 10-28 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme</p>		<p><b>Ligustrum Ovalifolium</b>                      Tipi: Shkurre Dekorative                      Familja: Oleaceae                      Lartësia: 3 - 4.6 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme                      Krasitet disa herë gjatë një sezoni në mënyrë që të mbajnë një formë të caktuar. Kur krasitet rregullisht bima nuk prodhon lule ose fruta.</p>
	<p><b>Prunus Cerasifera 'Pissardii'</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Rosaceae                      Lartësia: 8 - 12 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme                      Gjethet ndërrojnë ngjyrë në vjeshtë dheulet çelin në pranverë.</p>		<p><b>Salix Babylonica 'Aurea'</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Rosaceae                      Lartësia: 12 - 15 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell/pjesërisht hije / me lageshtirë                      Gjël bërimi: Gjetherënës</p>		<p><b>Ligustrum Ovalifolium Aureum</b>                      Tipi: Shkurre Dekorative                      Familja: Oleaceae                      Lartësia: 0.5 - 4 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme                      Krasitet disa herë gjatë një sezoni në mënyrë që të mbajnë një formë të caktuar. Ka gjethet të verdha/jeshile</p>
	<p><b>Prunus Sargentii</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Rosaceae                      Lartësia: 6 - 12 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: Gjetherënës                      Në pranverë gjethet ndërrojnë ngjyrë në portokalli dhe të kuqe.                      Pemë dekorative me lule rozë</p>		<p><b>Robina Pseudoacacia Fraisia</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Fabaceae                      Lartësia: 12 - 30 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: Gjetherënës                      Lulet çelin në muajin Maj</p>		<p><b>Buxus Sempervirens</b>                      Tipi: Shkurre Dekorative                      Familja: Buxaceae                      Lartësia: 0.5 - 8 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme                      Krasitet disa herë gjatë një sezoni në mënyrë që të mbajnë një formë të caktuar.</p>
	<p><b>Castanea Sativa</b>                      Tipi: Pemë Dekorative                      Familja: Fagaceae                      Lartësia: 20 - 35 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme                      Pemë me lule të bardha dhe me farë të ngrëshme (gështenja)</p>		<p><b>Olea Europaea</b>                      Tipi: Pemë Frutore                      Familja: Oleaceae                      Lartësia: 8 - 15 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme</p>		<p><b>Acuba Japonica</b>                      Tipi: Shkurre Dekorative                      Familja: Buxaceae                      Lartësia: 0.5 - 8 m.                      Rritja Optimale: Zonë me diell                      Gjël bërimi: E përshshme                      Krasitet disa herë gjatë një sezoni në mënyrë që të mbajnë një formë të caktuar.</p>

Fig.16

# LLOJET E BIMËSISË

## GYMNOSPERMS

















	<p>Tipi: Pemë Halore            Familja: Pinaceae            Lartësia: 10-25 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>		<p>Tipi: Pemë Halore            Familja: Pinaceae            Lartësia: 5 - 40 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>
	<p><b>Pinus Sylvestris</b>            Tipi: Pemë Halore            Familja: Pinaceae            Lartësia: 10-35 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>		<p><b>Cedrus Deodara</b>            Tipi: Bredh            Familja: Pinaceae            Lartësia: 5 - 40 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme            Gjethe që shpojnë</p>
	<p><b>Pinus Halepensis</b>            Tipi: Pemë Halore            Familja: Pinaceae            Lartësia: 10-25 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>		<p><b>Chamaecyparis Lawsoniense 'Ellwoodii'</b>            Tipi: Shkurre / Bredh            Familja: Cupressaceae            Lartësia: 0.5 - 8 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>
	<p><b>Picea Abies</b>            Tipi: Bredh            Familja: Pinaceae            Lartësia: 1-35 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>		<p><b>Picea Pungens 'Glauc'</b>            Tipi: Bredh            Familja: Pinaceae            Lartësia: 5-20 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>
	<p><b>Abies Alba</b>            Tipi: Bredh            Familja: Pinaceae            Lartësia: 1-50 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>		<p><b>Leyland Cypress</b>            Tipi: Shkurre / Bredh            Familja: Cupressaceae            Lartësia: 1-35 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>
	<p><b>Abies Balsamea</b>            Tipi: Bredh            Familja: Pinaceae            Lartësia: 1-20 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>		<p><b>Thuja Occidentalis</b>            Tipi: Shkurre / Bredh            Familja: Cupressaceae            Lartësia: 1-15 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>
	<p><b>Abies Balsamea</b>            Tipi: Bredh            Familja: Pinaceae            Lartësia: 1-20 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>		<p><b>Taxus Baccata 'Fatigiata Aurea'</b>            Tipi: Shkurre / Bredh            Familja: Taxaceae            Lartësia: 1-20 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>
	<p><b>Cedrus Atlantica 'Glauc'</b>            Tipi: Bredh            Familja: Pinaceae            Lartësia: 1-35 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: E përhershme</p>		<p><b>Roses</b>            Tipi: Trendafila            Lartësia: 0.5-2 m.            Rritja Optimale: Zonë me diell            Gjelbërimi: Gjetherënës</p>
			<p><b>Lule Kopshti</b>            Ranunculus, Camellia, Crocus            Narcissus, Bellus, Gladiolus,            Hyacinthus, Iris, Viola, Tulipa.</p>

Fig.17

## 9. MOBILIMI URBAN

Qëllimi në projektimin e këtij parku është realizimi i hapësirave të hapura të kënaqshme për bashkësinë qytetare, për ti motivuar ata të jenë aktivë, të socializohen me njëri-tjetrin si dhe të luajnë së bashku.

Elementët e dizajnit janë mjete kyçe me anë të së cilave planifikuesit, arkitektët dhe dizajnerat mund ti shtojnë varietetet dhe intrigë një parku urban. Përzgjedhja e duhur e tipit dhe materialit përcaktojnë mënyrën se si qytetarët do ta përdorin atë hapësirë publike.

Një faktor tjetër i rëndësishëm në përbërjen e një parku rekreativ është edhe mobilimi urban. Elemente si ndriçimi, stola, kosha për mbeturina, vazo lulesh, tenda pushuese, biciklete-mbajtëse, shatërvanë, sprucator për vaditjen e hapësirave të gjelberta etj, u dhurojnë qytetarëve një mjedis tërheqës, shlodhës, argëtues si dhe u ofrojnë atyre siguri.

### 9.1 Materialet sipërfaqësore

Përzgjedhja e materialeve sipërfaqësore duhet të pasqyrojë përdorimin më të mirë të mundshëm të një hapësire si dhe karakteristika të tjera si klimën, topografinë dhe preferencat lokale. Për shkak të kostos së tyre më të ulët si dhe qëndrueshmërisë mjedisore shpesh në projektim preferohen materiale vendase.

Ngjyra e një sipërfaqeje të caktuar luan gjithashtu një rol të rëndësishëm për sa i përket nivelit të rehatise së përdoruesëve të asaj hapësire. Në këtë projekt janë evituar hapësirat me ngjyra të errëta të cilat përthithin nxehtësinë në stinën e verës. Gjithashtu ngjyrat tepër të celta si pllaka të bardha apo gri e hapur pasi gjatë orëve të pikut krijojnë shkëlqim e mund të krijojnë pakënaqësi tek përdoruesit e kësaj hapësire.

Për ta bërë një hapësirë sa më shumë të aksesueshme, tekstura ka një rëndësi të vecantë. Sipërfaqet e lëmuara mund të duken bukur për syrin, por mund të jenë të rrezikshme në stinën e dimrit kur shirat janë të pranishëm. Si rrjedhojë, në aksin qëndror të këtij parku urban është propozuar shtrim me beton të stampuar.

### 9.2 Ndriçimi

Ndriçimi përcakton karakterin dhe dobinë e një hapësire të caktuar. Loja me dritën i jep një hapësire një dimension estetik si dhe luan një rol të rëndësishëm për sa i përket sigurisë. Për të qenë sa më të suksesshëm, parqe të tilla urbane përveç aspektit estetik duhet të falin edhe siguri tek banorët. Ndriçimi është përdorur si një mekanizëm për të reduktuar rreziqet e për të shtuar ndjenjën e besimit në komunitet.

Në aksin kryesor të parkut, me gjatësi prej 832m dhe 5m gjërësi, propozohen shtylla metalike me dy koka, me lartësi 3.5m e me një distancë 20m nga njëra tjetra. Ky lloj ndriçimi është përshtatur me identitetin dhe funksionin e kësaj rruge duke mbuluar të gjithë këtë aks.

Në rrugën dytësore, me gjatësi prej 666m dhe 1.8m gjërësi, propozohen shtylla metalike me një kokë, me lartësi 2 meter e me një distancë 12m nga njëra tjetra. Ky lloj ndriçimi është menduar i mjaftueshëm në përputhshmëri me gjërësinë e kësaj rruge.

Për sa i përket ndriçimit të rrugëve tretësore (shtigjeve), të cilat në total përbejnë një gjatësi prej 380 m dhe gjërësi prej 1.6m, propozohen ndriçues LED me lartësi 60 cm e me një distancë 6m nga njëri-tjetri.

Gjithashtu, me ndriçim të mjaftueshëm janë pajisur edhe zona të tjera të parkut; si korsia e biçikletave, ajo e vrapimit, terrenet sportive, palestra në natyrë, këndi i shahut, kopështi i trëndafilave etj. Përkatësisht:

- Korsia e biçikletave, korsia e vrapimit dhe palestra në natyrë janë pajisur me ndriçues LED me lartësi 60 cm e me një distancë 6m nga njëri-tjetri.

- Kopështi i trëndafilave është pajisur me ndriçim të alternuar, shtylla metalike me një kokë, me lartësi 2m e me një distancë 12m nga njëra-tjetra, si dhe ndriçues LED me lartësi 60cm e me një distancë 6m nga njëri tjetri.

- Këndi i shahut dhe sheshi pranë baseneve ujore janë pajisur me shtylla metalike me një kokë, me lartësi 2 m.

- Terrenet sportive; si fusha e tenisit e volejbollit dhe e basketbollit janë pajisur me shtylla metalike e prozhektorë, me lartësi 4.5 m e fuqi 250W.

- Për t'u falur qytetarëve një hapësirë sa më të sigurt, ky park është pajisur me dy prozhektorë të pozicionuar në dy skajet e tij, të cilët do të jenë funksionalë gjatë mbrëmjes dhe orëve të natës. Këto prozhektorë do të fiksohen në shtylla me lartësi minimale 15m.

- Për të shtuar larminë e ndriçuesve janë projektuar tre akse të mbjella me pemë si manjola dhe qershia, të cilat janë pajisur me ndriçues të jashtëm LED nën dysheme, me një distancë 5m nga njëri-tjetri. (Fig.18)




Fig.18 Plani i rrjetit elektrik

### 9.3 Stolat e Parkut

Një element tjetër i rëndësishëm për sa i përket mobilimit urban janë edhe stolat. (Fig.19) Projektimi i tyre përgjatë një rruge apo brenda një sheshi përçon një mesazh rreth asaj hapësire dhe e bën atë më mikpritëse. Hapësirat e pushimit u tregojnë përdoruesve që një rrugë është më tepër se një lëvizje individuale, duke imponuar një sjellje të caktuar. Gjithashtu, stolat, nëpërmjet vendosjes sipas një orientimi të përcaktuar, përkufizojnë akoma më mirë këto hapësira pushimi. Prezenca e stolave dhe vendeve të pushimit në një hapësirë urbane është një motor gjenerues për të gjithë zonën.



Fig.19 Plani i mobilimit urban

Në projektin e parkut janë parashikuar katër lloje stolash (Fig.20) ;

- Stola metalik dhe druri standard me gjatësi 210 cm.

Profilet lidhës të strukturës metalike janë të punuar me dekor me motive florale. Ristelat e drurit janë të zmusuara dhe të fiksuara për së gjati me anë të vidave dhe bulonave. Stola të tillë janë parashikuar përgjate aksit kryesor, ku fluksi i përdoruesëve është më i madh, si dhe në këndet e lojrave për fëmijë.

- Stola betoni të parafabrikuar me gjatësi 260 cm në formë drejtkëndore dhe harkore.

Bloqe betoni të parapërgatitur veprojnë si strukturë, mbi të cilën fiksohen ristela druri me anë të vidave dhe bulonave. Stola të tillë janë parashikuar në sheshin pranë baseneve ujore, si dhe tek palestra e hapur në natyrë.

- Stola betoni të prodhuar në vend me gjatësi variabël.

Mbi sipërfaqen e bordurave të betonit fiksohen ristela druri të zmusuara me përmasa që variojnë në bazë të specifikave të projektit. Stola të tillë janë parashikuar në këndin e lojës së shahut si dhe në disa hapësira të tjera pushimi në park.

- Stola druri me këmbë metalike rreth e qark pemëve.

Mbi sipërfaqen e një strukture druri që mbart funksionin e dyshemesë, rreth e qark pemëve fiksohen ristela druri të zmusuara të cilat do të shërbejnë si vend pushimi për përdoruesit e kësaj hapësire. Stola të tillë janë parashikuar në këndin e lojës së shahut.



Fig.20 Llojet e stolave të propozuar

#### 9.4 Kosha për grumbullimin e mbeturinave

Nje mjedis i pastër luan një rol të rëndësishëm në frekuentimin e një hapësire. Vendosja e koshave të mbeturinave përgjatë aksit kryesor dhe pranë stolave, pikë së pari shërben për të mbuluar nevojat e përdoruesve, si dhe rrit ndërgjegjësimin qytetar. Gjithashtu duke analizuar edhe fluksin është parë e arsyeshme që një numer i caktuar prej 10 koshash të vendosen në sheshin qendror pranë baseneve ujore ku aktiviteti rekreativ është me dinamik. (Fig.21)

## 9.5 Vazo lulesh

Një hapësirë urbane përbëhet nga detaje të cilat shtojnë ngjyrat e tërheqin interesin e shumë përdoruesëve. Në dizajn një detaj i rëndësishëm janë edhe lulet. Përdorimi i tyre pranë këndeve të pushimit si dhe pranë hapësirave ujore sjell vitalitet si dhe krijon një pike atraktive. Edhe pse në të gjithë parkun gjelberimit i është dhënë një rëndësi e vecantë, për të përforcuar këtë nocion janë propozuar vendosja e vazove me lule pranë stolave të pushimit. (Fig.21)

## 9.6 Tenda pushuese (Pergola)

Tendat pushuese janë një element tjetër plotësues i dizajnit urban. Ato jo vetëm sjellin ngjyrim vizual por edhe shërbejnë si pikë referimi si dhe hapësira pushimi për përdoruesit e një hapësire. Konkretisht në këtë projekt janë propozuar katër tenda (pergola) në material druri të cilat krijojnë hijëzim e strehë në kohë dhe periudha të caktuara të vitit. (Fig.21)



Fig.21

## 9.7 Biçikletë-mbajtëse

Për të përmbushur nevojën e përdoruesëve të bicikletave, në hyrjen kryesore të parkut pranë korsisë së bicikletës është propozuar implementimi i një bicikletë-mbajtëse me strukturë hekuri dhe strehëz xhami. Xhami do të shërbejë si strehëz për ti ruajtur bicikletat nga shiu dhe dielli i fortë në stinën e verës. Të gjitha raftet e biçikletave janë bërë nga tuba industrial standard ose çeliku inox. Çeliku standard është i veshur me pluhur në 1 nga 6 ngjyra për të siguruar mbrojtje nga korrozioni dhe ndryshku. Çeliku inox ka cilësi mbrojtëse natyrale për të parandaluar nxirjen dhe ndryshkun gjatë përdorimit të rregullt. (Fig.22)

## 9.8 Shatërvanë

Uji si një element tepër i rëndësishëm i dizajnit urban zë një hapësirë të konsiderueshme në sheshin qendror të këtij parku. Së bashku me basenet ujore, në projekt është parashikuar edhe sistemi i dy shatërvaneve të cilat do të pozicionohen në qendër të secilit basen. (Fig.22)



### 9.9 Sprucator për vaditjen e hapësirave të gjelberta

Për vaditjen e hapësirave të gjelbërta propozohen 230 copë sprucator me këto karakteristika: Rreze 40-360° , presion 1.7-4.5 ATM, rreze mbuluese 8.2-15.2m, prurje uji 180-190 litra/orë si dhe filetim 3/4 POL. (Fig.22)



Fig.22

## 10. RRETHIMI I PARKUT

Rrethimi është një tjetër element i rëndësishëm, evidentues dhe plotësues i parkut. Pjesë përbërëse e dizajnit të kangjellave janë edhe kollonat ekzistuese, ndërtuar së bashku me kapanonet që përfshiheshin në zonën ushtarake. Kollonat kanë një lartësi prej 4m dhe me dy madhësi të ndryshme, 40x40 cm në rastin kur lidhin murin rrethues, si dhe 65x65 cm në portat hyrëse.

Në varësi të madhësisë së tyre është përcaktuar edhe hapësira nga njëra kollonë në tjetrën, përkatësisht 265 cm dhe nga aksi në aks 318 cm. Ndërsa, përsai përket portës hyrëse hapësira mes tyre është 540 cm dhe nga aksi në aks 605 cm.

Duke qenë se do të ruheshin kollonat, të cilat dëshmojnë stilin e vecantë romak, thjeshtësinë e tyre, si dhe fakti që e gjithë kjo hapësirë tani do të jetë i vetmi park në qytet, u mendua që si element bazë i dizajnit të zgjidhej pema e ullirit dhe elementët vertikalë. Vetë pema e ullirit është tepër prezente në qytetin tonë, favorizuar edhe nga kushtet klimaterike dhe pjesë përbërëse e parkut, duke qenë se është pemë që qëndron e gjelbër gjatë gjithë vitit. Ndërsa elementët vertikalë lejojnë aksesueshmëri të plotë të parkut nga këmbësorët apo makinat, duke minimizuar cdo lloj pengese vizive.

Kangjellat mund të trajtohen si tre module në total, ku dy nga to do të jenë pjesë e rrethimit dhe njëra do të jetë porta hyrëse. Duke menduar edhe afërsinë që kemi me detin dhe rrezikshmërinë që paraqesin elementët vertikalë duke përfunduar me majë, u mendua një mbyllje e valëzuar, e cila do të përsëritet 18 cm më poshtë, nga ku lartësia më e madhe që shkon në njërin cep të

kollonës është 340 cm, ndërsa nga cepi tjetër 280cm. Moduli, i cili do të përsëritet do të përbëhet nga shufra metalike vertikale, përkatësisht 18 shufra me diameter 8 cm, nga ku 9 prej tyre do të përfundojnë me gjethe të ullirit e stilizuar, vendosur në majë, në hapësirën mes dy valzimeve. Një tjetër element i rëndësishëm që vlen për t'u theksuar është edhe mbyllja e këtyre shufrave, nga ku pjesa fundore e modulit do të përbëhet nga një fletë metalike e stilizuar, e cila do të personifikojë rrenjët dhe shtrirjen e madhe që ka kjo pemë. Ky modul do të ketë një ngritje nga toka me 12 cm. (Fig.23)




Fig.23

Ndërsa moduli i dytë do të jetë njësoj me të parin, por do të jetë një shëmbëlltyra e tij përta i përket shufrave metalike dhe mbylljes së stilizuar në pjesën lart, me ndryshim në dizajnin e fletës metalike të vendosur në pjesën e poshtme. (Fig.24)



Fig.24

Ndërsa, porta hyrëse, përveç të gjithë atyre që u thanë më lart, element identifikues ka degën e ullirit, e cila do të vendoset në qendër të portës duke prishur ritmin vertikal të shufrave metalike.(Fig.25)




Fig.25

Trajtimi i kollonave nuk do të ketë trajtim tjetër përveç atij që ai ka patur, restaurim e lysterje, duke ruajtur thjeshtësinë e dikurshme. Pjesë përbërëse e tyre do të jenë edhe ndriçuesit, vendosur në lartësinë 280 cm dhe 340 cm, përkatësisht në lartësinë e moduleve. Ndriçimi është menduar vertikal, i tillë që të japë ndriçim në të gjithë kollonën, duke patur element dekorues përsëri gjethen e ullirit.(Fig.26)




Fig.26

Përsa i përket rrethimit anësor, mund të themi që trajtimi i tij do të jetë ndryshe, duke u fokusuar në restaurimin e murit ekzistues apo ndërtimin e pjesëve në të cilat ai mungon, në një lartësi prej 1.5 m.

## 11. IMPLEMENTIMI

Zbatimi i projektit të Parkut Rekreativ Qëndror Kavajë, për arsye të mirëmenaxhimit të kapaciteteve njerëzore dhe financiare, është menduar të konkretizohet në dy faza. Secila faza do të përfshijë ndërhyrje dhe punime të mirëcaktuara në materialet përkatëse, siç janë hartat treguese, zërat e punimeve referuar preventivit dhe relacionet shpjeguese.

### Faza I

Duke marrë shtysë nga situatë aktuale e zonës e cila ndodhet në një gjendje tepër të degraduar si pasojë e keqpërdorimit të kësaj hapësire nga qytetarë dhe individë të ndryshëm për vendebozitim të mbetjeve inerte, faza e parë si prioritet të saj ka pastrimin, sistemimin dhe punimet në infrastrukturën e projektit. Në këtë fazë është menduar të kryhen punime në të gjithë zonën siç janë:

- Punime pastrimi dhe sistemimi të zonës nga materialet e ngurta
- Punime infrastrukturore dhe dranazhuese
- Punime rrethimi me materiale të lehta
- Punime në akset rrugore, rrugë kryesore do të përfshijë vendosjen e shtresave përkatëse siç janë shtresë stabilizanti, çakull, beton ...etj
- Në akset dytësore shtrimi i rrugëve me pllaka granili etj.
- Punime në korsinë e biçikletave shtresë stabilizanti, shtresë binderi, shtresë asfaltbetoni, emulsion bituminoz etj.
- Punime në korsinë e vrapimit dhe në aksin tretsor duke vendosur shtresa stabilizanti, asfaltbetoni etj.
- Gjithashtu në punimet e gjelbërimit do të vendoset shtresa mushëse me humusor, mbjellje pemësh e lulësh decorative etj.

- Punime në ndriçimin e aksit kryesor dhe të korsisë së vrapimit siç janë vendosja e shtyllave, hapja e pusetave kontrolluese, vendosja e kabllave përkatës etj.

Të gjitha punimet e lartpërmendura, por jo vetëm, do të realizohen në fazën e para të zbatimit të projektit të parkut rekreativ qëndror të qytetit Kavajë.

## **Faza II si vazhdim të punimeve mbi fazën e parë**

Në fazën e dytë janë parashikuar punime, të cilat finalizojnë zbatimin e projektit në fjalë. Në këtë fazë do të plotësohet parku rekreativ duke vendosur kënde lojrash për fëmijë, vendë argëtimi dhe relaksuese për moshën e thyer, facilitete sportive (fusha basketbolli, pajiste gjimnastikore metalike, etj).

### **6.8 Palestra në natyrë**

Palestra në natyrë, në krahasim me funksionet e tjera, ka një planvendosje më të veçantë. Duke u ndodhur në jug-lindje të projektit të parkut, palestra e jashtme ka formën e rregullt rrethore dhe përshkohet në skaj nga një segment tretësor me formë gjarpëruese, i cili krijon akses ndërmjet palestrës dhe shtegut kryesor (parësor), si dhe vazhdon për të krijuar një lidhje spontane me pistën e vrapimit. Vendimi i marrë gjatë fazës së projektimit për ta vendosur këtë funksion pikërisht në këtë pozicion, erdhi si rezultat i potencialit të hapësirës së krijuar ndërmjet shtegut kryesor dhe pistës së vrapimit. Kjo e fundit, duke pasur në vetvete formë organike, e përshkon paralelisht palestrën e jashtme në gjysëm-perimetër, duke e përkufizuar hapësirën dhe peisazhin që krijohet.

### **6.7 Terreni sportiv**

Terreni sportiv është pozicionuar në jug-perëndim të projektit të parkut, qoftë për arsye afriteti me fushën e sportit, që është një hapësirë kufitare me zonën jugore të parkut, e cila, ndonëse nuk është pjesë e projektit, është marrë parasysh si faktor i jatshtëm i rëndësishëm, qoftë edhe nga këndvështrimi planifikues. Bimësia, në kufij midis pronës së projektit të parkut dhe fushës së sportit, është trajtuar me bimësi me dendësi të rrallë dhe me numër të kufizuar rrënjësh, për të ruajtur komunikim vizual me fushën. Aksesit midis parkut dhe fushës së sportit është neglizhuar, për arsye që kanë të bëjnë me sigurinë e parkut gjatë natës. Më në perëndim, nga planvendosja e pronës së projektit, terreni ka formë të thyer drejtëkëndore, duke krijuar aneks drejt perëndimit.

Terreni sportiv, megjithëse është midis kontureve më të rregullta drejtkëndore, shton edhe frekuentimin e këtij aneksi, i cili me mospraninë e një funksioni të rëndësishëm siç është terreni sportiv, do të ishte një hapësirë qorre apo e vdekur, siç përkufizohet edhe në arkitekturë.

Specifikisht, terreni sportiv përbëhet 1 fushe tenisi dhe 1 fushë basketbolli. Përmasat e këtyre fushave janë standarte dhe në projekt është parashikuar që bankinat rrethuese përreth fushave të jenë sa më të gjëra për t'i dhënë hapësirë përdoruesve edhe në aktivitete plotësuese, si nxemje apo si hapësirë për spektatorë.

Më konkretisht, fusha e tenisit, me përmasa standarte 27x13 m plotësohet me shesh rrethues në formën e bankinës përreth perimetrit me gjerësi 4 m në gjatësi të fushës dhe 7 metra në gjerësi të fushës. Fusha e basketbollit, me përmasa standarte 28x15 m, plotësohet me shesh rrethues në formën e bankinës, me gjerësi 2 m përreth të gjithë perimetrit. Shtrimi i këtyre fushave është parashikuar të jetë me tartan mbi një shtresë betoni të përfocuar me zgarë hekuri  $\varnothing 70$ . Aplikohet mbushje me zhavorr mbi dhë të ngjeshur. Parapakisht, është i domosdoshëm konturimi me bordura të prefabrikuara në perimetër, ku gërrmohet në kuotë më të ulët se kuota e dheut të ngjeshur, dhe pas mbushjes me zhavorr, hidhet në vend beton për fiksimin e bordurave. Si sipërfaqje, fushat e tenisit zë 333 m<sup>2</sup>, ndërsa fusha e basketbollit zë 432 m<sup>2</sup>.

Ndërimi i terrenit sportiv, është parashikuar të mundësohet nëpërmjet 14 prozhektorëve standart për fushat e volejbollit dhe basketbollit, ndërsa ndërimi i trotuarëve të aksesit të mundësohet nga shtyllave ndriçuese të tipit h=2 m dhe tipit h=3,5 m .

Terreni sportiv, i cili përfshirë dy fushat sportive bashke, zë një sipërfaqje në total prej 765 m<sup>2</sup>.

## 6.1 Këndi e lojrave për fëmijë

Propozimi i këtij këndi, me sipërfaqe totale prej 640 m<sup>2</sup> erdhi si rezultat i konkluzioneve të nxjerra gjatë fazës së analizave mbi domosdoshmërinë e një këndi të dytë lodrash në projekt. Planvendosja u caktua në zonën perëndimore të projektit të parkut, përgjatë segmentit të aksit kryesor, pranë edhe hyrjes perëndimore. Ky kënd synon grypmoshë më të vogël, 3 deri në 7 vjeç, dhe , sikurse në këndin e madh të lojrave përfshin shesh rrethues të mobiluar me stola dhe shtylla ndriçimi, si dhe me elementë peisazhi të ngjashëm. Veçoritë arkitektonikë karakterizojnë këtë kënd si më poshtë:

- Shesh rrethues i këndit të vogël të lojrave i shtruar me beton të derdhur në vend dhe dekori i shtresës së sipërfaqjes të punohet me shabllone të përcaktuar në bazë të projektit. Aplikohet mbushje me çakull mbi dhë të ngjeshur. Mobilimi urban përmban stola dhe shtylla ndriçimi. Sipërfaqja: 394 m<sup>2</sup>
  - Shesh lojtrash për fëmijë të grupmoshës 3 deri në 7 vjeç. Mbushje me rërë mbi dhë të ngjeshur. Mobilimi me lodra fikse të tipologjisë: rrëshqitësë (strukturë PVC-je dhe fibrash xhami me ngjyra të ndryshme) Sipërfaqja: 246 m<sup>2</sup>.

## 6.2 Sheshi qëndror me basenet ujore

Domosdoshmëria e një atraksioni qëndror të projektit të parkut, për të përmbushur jo vetëm qëllimin që një kompleks i tillë rekreativ ka në vetvete, por edhe për të pasur një pikë referimi (landmark) është plotësuar nëpërmjet elementit të ujit, i cili, në projektin e propozuar është edhe elementi më dominant i sheshit, duke u integruar më së miri me peisazhin e gjelbëruar përreth.

Sheshi qëndror së bashku me sipërfaqjen ujore arrin në një sipërfaqje totale prej 355 m<sup>2</sup>. Veçoritë teknike karakterizojnë këtë shesh si më poshtë:

### b. Sheshi qëndror

Sheshi qëndror të jetë i shtruar me pllaka granili mat kundra-rrëshqitjes. Së pari aplikohet mbushje çakulli mbi dhë të ngjeshur, hidhet beton i varfër për të shtruar dy shtresa hidroizolim dhe më pas rrafshohet me rërë-çimento si bazë për ngjitje me koll të pllakave. Sipërfaqja: 400 m<sup>2</sup>

### b. Basenet ujore

- Basenet ujore, në vetvetë është një sistemi i mirëfilltë inxhinierik dhe arkitektonik ndërtimi që funksionon nëpërmjet impianteve. Sipërfaqje ujore është ndarë në dy basene me sipërfaqje totale 335 m<sup>2</sup>. Së bashku me basenet ujore, është parashikuar në projekt edhe sistemi i shatërvaneve. Pavarasisht se janë dy objekte të veçanta, dhomat teknike dhe depozitat e ujit janë projektuar në mënyrë të tillë që e njejta strukturë ndërtimi t'i shërbejë të dy baseneve. Kjo strukturë është e planvendosur nëntokë deri në kuotën -3,00 m dhe përfshinë zonën midis dy baseneve. Aksesit sigurohet nëpërmjet baxhave që kanë dalje në sheshin qëndror. Veçoritë më të detajuara arkitektonike dhe inxhinierike të baseneve ujore vijojnë si më poshtë;
- Depozita kompensimi të nivelit të ujit të baseneve; 2 njësi me nga 14 m<sup>2</sup> secila. Njëra e planvendosur në veri dhe ndan një segment muri me basenin e madh, ndërsa tjetra është e planvendosur në jug dhe ndan një segment muri me basenin e vogël. Kjo lloj vendosje është kusht i domosdoshëm për të siguruar daljen dhe lidhjen me tubacionet e nevojshme për mirëfunksionimin e impiantit. Struktura e karabinasë përbëhet nga pllakë themeli me trashësi 30cm, mure perde me trashësi 25 cm dhe soletë betoni 20 cm. Veshja e brendshme të jetë me qeramikë me përmasa 33x33x1cm. Hidroizolimi aplikohet pas shtresës së varfër të rrafshimit për themelin, si edhe mbas hedhjes së themelit. Përpara hedhjes së betonit të murit perde mbi pllakën e themelit, aplikohet gominë hidro-izoluese.
- Dhoma teknike, me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>, është pozicionuar ndërmjet dy baseneve me mure të përbashkët për të lehtësuar daljen e tubacioneve të furnizimit dhe shkarkimit të impiantit, si dhe duke gjykuar afërsinë që kanë dy basenet me njëra tjetrën, një dhomë teknike është e majftueshme për t'i shërbyer të dy baseneve njëkohësisht. Në projekt janë

parashikuar 4 njësi pompa 3,5 KW për furnizimin e basenev me ujë, nga dy njësi për secilin basen,dhe dy njësi pompa 5,5KW për funksionimin e tre njësi sprucatorë shatërvani në basenin e madh, dhe dy njësi sprucatorë shatërvani në basenin e vogël. Secili sistem shatërvani funksionon nëpërmjet një pompe. Në zbatim të projektit, veçori teknike të pompave si fuqia apo lloji, janë për t'u rishikuar në bazë të projektit elektrik dhe mekanik. Gjithashtu, sasia në njësi e filtrave të parashikuar në projekt duhet të shqyrtohet. Për momentin janë parashikuar 4 njësi filtra me diametër  $\varnothing 1200$ , nga dy njësi për secilin basen. Struktura e karabinasë përbëhet nga pllakë themeli me trashësi 30cm, mure perde me trashësi 25 cm dhe soletë betoni 20 cm. Veshja e brendshme të jetë me qeramikë me përmasa 33x33x1cm. Hidroizolimi aplikohet pas shtresës së varfër të rrafshimit për themelin, si edhe mbas hedhjes së themelit. Përpara hedhjes së betonit të murit perde mbi pllakën e themelit, aplikohet gominë hidroizoluese.

- Teknikisht, të dy basenet ujore kanë strukturë të njëjtë, nga ku ndryshimi i vetëm janë përmasat; baseni i madh ka sipërfaqe prej 295,3 m<sup>2</sup> sipërfaqe uji, ndërsa i vogli ka sipërfaqe 131 m<sup>2</sup>. Detyrimisht edhe përmbajtja sasiore e materialeve është në proporcion me sipërfaqen. Struktura e karabinasë përbëhet nga pllakë themeli me trashësi 30cm, mure perde me trashësi 25 cm dhe mbi muret perde, me beton të derdhur në vend dhe do të mbivendosen bordura me gjerësi 40cm, lartësi 20cm dhe gjatësi, të cilat variojnë në baze të skicave të projektit. Mbi këto bordura, në projekt, janë parashikuar të aplikohen ristela druri që do të kryejnë rolin e ndjenjësve për tu ulur. Tabani, sipërfaqja e brendshme e mureve, si dhe pjesa e zbuluar e mureve perde në shesh, në projekt, janë parashikuar të vishen me shtresë pllake graniti multi-kolor me përmasa 12,5x25x0,9 cm. Hidroizolimi aplikohet pas shtresës së varfër të rrafshimit për themelin, si edhe pas hedhjes së themelit. Përpara hedhjes së betonit të murit perde mbi pllakën e themelit, aplikohet gominë hidroizoluese.
- Ndryshimi i baseneve ka si qëllim, jo vetëm ndryshimin, por edhe estetikën e sheshit gjatë mbrëmjes. Në projekt janë parashikuar 14 njësi shtylla ndryshimi h=2 m . Baseni i madh përmban 28 njësi ndryshues in-kaso në kuotë nën nivelin e ujit, ndërsa baseni i vogël përmban 14 njësi të tilla.